

8SH-32

M 98

AFRORA

FLORA
MULLAYMERI

Duke kërkuar një emër

TREGIME

891-585-32

nr 98

FLORA MULLAYMERI

S

DUKE KËRKUAR NJË EMËR...

(Tregime)

~~52549~~

LIBRERIA E SHTETIT
SHKURTORIA

2768

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

DUKE KËRKUAR NJË EMËR...

Një krijesë e vogël mernte frymë nën pelenat e bardha.

Dy palë sy e vështronin dhe dukej sikur nuk ngopeshin së pari.

Kaq kohë e kishin pritur atë: Së fundi e kishin aty, aq pranë, ashtu të vockël, sa nuk dinte ç'ishte bota, krijesë njomëzake dhe e dashur. Leni nuk fliste fare. Astriti shikonte herë atë, herë të bijën, që sapo kish ardhur në jetë dhe ndjente se sa shumë i donte të dyja e, në ato çaste, s'ish në gjendje të tregonte se cilën donte më fort.

— Leni... po emrin?

Leni ngriti ngadalë sytë e bukur, rreth të cilëve po shuhej një shirit i errët e i dha atij të kuptonte se çdo gjë ish në rregull... edhe emri. Po ai donte ta dinte, donte që krijesa e tij të kish emër, emër të bukur:

— U bënë shtatë ditë, Leni; duhet regjistruar në gjendjen civile.

— Kristina — tha Leni dhe qeshi, duke treguar një palë dhëmbë të rregullt, të bardhë. Astriti u kthye në çast e foli rrëmbyer:

— Leni, lëri shakatë, ne më duket kemi bise-
duar për këtë.

Ajo uli kryet dhe u duk se fytyra i mori zjarr.

— Astrit, — murmuriti pastaj ngadalë — në-
nën e desha shumë. Vdiq e re, nuse, ishte punë-
tore dhe dua që Kristina jonë (këtu i mëshoi zë-
rit më tepër si për të marrë kurajë) të ketë em-
rin e saj e të bëhet e bukur si ajo.

Astritit nuk i erdhi mirë. E vështroi të sho-
qen nga koka deri në këmbë dhe pastaj shikoi
nga e bija, thujse kjo krijesë e njomë kish sje-
llë sherrin midis tyre. Nuk i bënte zemra të ngrin-
te as kokën; ishte ulur afër krevatit të së voglës
dhe sillte nëpër duar një lidhëse të pelenave të
saj. Ai donte të fliste përsëri, ta bindte Lenin
me arësyetim dhe ta zbutte pak atmosferën. e rën-
dë, që u krijua fare papritur, po Leni sikur ja kup-
toi mendimin dhe nuk e la të vazhdonte:

— Astrit, unë nuk e kuptoj ç'të prish ty emri.
Kristina! (e përsëriti dy herë)... dëgjon? Sa bukur!
Kristi! E ndjera nënë! Kështu e thërriste babai,
Kristi!

— Leni, unë dua që vajza jonë të ketë emër
shqiptar, më kupton? Me «Kristin» ti po na sjell
Krishtin këtu. Po deshe i vëmë ndonjë emër që
dëgjojmë nëpër qytet, fjala vjen... Zana...

Leni, e skuqur në fytyrë, nxitoi t'i përgjigjej:

— Ashtu? Po këto Suzanat ç'janë? A s'po
na bëhet një sallatë emrash këtu? — heshti një
çast dhe pastaj vazhdoi: — i vëmë emrin e nënës
sate, Hava... u kënaqe tani?

Astriti u nxeh me të vërtetë, por u përmbajt:

— Dëgjo, Leni, ne të dy më duket se nuk po

kuptohemi. Ç'hyn në këtë mes nëna ime, nëna jote... dreqi ta marrë?

Ai u ngrit dhe filloi të vinte rrotull dhomës. Shikoi orën. Ishte akoma shpejt për në punë. U dëgjua zhurma e postierit që lëshoi gazetën në korridor. Ai e mori dhe u ul të lexonte, po dukej që nuk e kishte mendjen fare atje, sepse mbeti vetëm duke parë një klishe në krye të saj. Leni, si për inat (dhe Astriti e dinte që ajo inatosej shpejt) vente e vinte rrotull krevatit të së vogëlës dhe rrallë i hidhte sytë nga ai.

Astriti u ngrit, nuk i rrihej në një vend, ndoshta nga inati, ndoshta nga dëshira për ta parë përsëri të bijën. Iu afrua krevatit dhe, kur e pa, sikur i harroi të gjitha. Buzëqeshi dhe, sikur të mos kish ndodhur asgjë e, gati-gati, sikur të këndonte një këngë gazmore, u drejtua nga Leni:

— Leni, shiko sa e bukur duket!

Ajo s'u përgjegj.

— Leni, përse të zihemi kot së koti? Nëna ime dhe nëna jote kanë vdekur. Ne i deshëm, i nderuam dhe i kujtojmë me nderim, po ç'rëndësi kanë emrat? Dhe në fund të fundit ata s'janë emrat tanë; njëri turk e tjetri grek.

Leni turfulloi me zëmërim:

— Në fund të fundit... a s'kam edhe unë të drejtat e mia në këtë shtëpi?

Që jashtë ndiheshin zhurmat e atyre që shkonin në punë; pastaj dikush, duke ikur, e thirrte Astritin me emër... po ky s'u përgjegj, hodhi cigaren e ndezur përtokë, u vesh në heshtje aty në korridor dhe doli.

Qyteti i vogël ish në lëvizje. Këtej kalonin shokët e Astritit, punëtorë të bonifikimit, kurse nga ana tjetër, nga fusha e panxharit, po derdhe-shin punëtorët e kombinatit të sheqerit, që tash-ti merrnin turnin e mëngjezit.

Koha ishte e vrejtur dhe retë dukej sikur po shtrydhnin mbeturinat e fundit, se filloi të binte një shi i imtë. Në fillim Astriti s'e ndjeu, sepse nuk e kishte mendjen aty, po kur filloi t'i lagte qafën, u kujtua të ngrinte kapuçin e mushamasë.

Në rrugë takoi shokët. Dikush qeshi aty nga mesi i turmës. Astriti buzëqeshi me vete... në fund të fundit, ç'të keqe kish... pse të mos qeshite? Ç'kish ndodhur? Asgjë! Ç'budallallëk! Të zihesh me të shoqen kot së koti (atij i sëmboi në zemër kur kujtoi Lenin dhe atë që kish ndodhur) E përse? Për një emër!

Astriti ecte pa vështruar njeri në sy, ecte me kokën ulur sikur të kërkonte diçka përtokë. Askush s'e kish mendjen ta pyeste se ç'kish. Disa ditë më parë e kishin uruar për vajzën e tani ndoshta e dinin që ish i qetë e prandaj, si për inat (kështu i dukej atij), nuk i flisnin (sikur të kishin frikë mos i prishnin gëzimin që i kish ardhur). I erdhi inat, u shkëput nga shokët dhe filloi të ecte nxituar, pa e kthyer kokën mbrapa. Arriti në vendin e punës më shpejt se ditët e tjera. Kantieri që i zbrazët, veglat e punës ishin në depo e magazinieri ishte duke ardhur me shokët.

Astriti pështyu përtokë, hoqi mushamanë e gjatë dhe filloi të vinte rrotull pa ditur ç'të bënte. Atë ditë do të hapnin kanal. Toka ish e lagur

dhe, si dukej, do të bëhej llucë, sepse shiu vazh-
donte të binte gjithnjë i imtë.

Astriti shkoi te vendi i tij. Deri sa të vinte magazinieri mendoi të pastronte vendin e punës. Kish aty driza të shkulura përgjysmë nga eskavatori, por që akoma ishin të ngulura në tokë. Të paktën ashtu, pa vegla, mendoi të hiqte shumicën e tyre, ato që ishin përsipër; por toka ish e lagur dhe me pak mundim ai mundi të shkulte një pjesë të mirë. Ai ish i fuqishëm, me shpatulla të gjëra e me shtat të lartë. Në cep të syrit të majtë kish një nishan që herë-herë (kjo i ndodhte kur ish i zemëruar) i lëvizte sikur të ishte ndonjë mizë e vogël. Edhe tani i ndjente dridhjet e tji dhe padashur mendoi: «Çudi, sa shpejt prekem... e kam këtë dobësi... edhe Leni e di dhe prandaj ngul këmbë në të sajën. Po, po! Ajo e di se do të thyhem! Po këtu nuk është fjala për një tekë.» Që larg dalloi shokët. Ai vrapoi në depo dhe mori veglat e tij.

— Astrit, ke shkrepse? — i thirri magazinieri që prapa.

— Jo, për djall e kam harruar sot në shtëpi.

Astriti kontrollloi edhe një herë xhepet si për t'i mbushur mendjen tjetrit dhe pastaj vrapoi për te vendi i tij.

Ai e nguli kazmën thellë dhe, sa më thellë gërmonte, aq më tepër rrënjë të ngatërruara dilnin. Vërtet në thellësi kish rrënjë të ngatërruara, por vjetët i kishin kalbur dhe Astriti s'e kish vështirë t'i shkulte. Ai i shkulte, i merrte pastaj dhe, duke i vërtitur nëpër duar, i hidhte larg. Murmurinte me vete melodinë e një kënge, por pada-

shur diçka iu kujtua. «Budalla! E pse, ç'ka ndodhur? Asgjë! E vogla është jotja, edhe Leni jotja. Emri? E ç'rëndësi ka emri? Le të ketë ç'emër të dojë, ty ç'të prishi?» «Jo, jo — nxitoi t'i përgjigjej vehtes aty për aty — duhet një emër shqiptar. Unë, jam bir i klasës punëtore! Po si më tha Leni? — i vemë emrin e nënës sate!»

Dhe iu kujtua nëna e tij.

«Edhe nëna ime vdiq e re, edhe ajo ish e bukur e punëtore. Po pse ma kujtoi Leni në atë mënyrë, si për t'u hakmarrë me mua?»

I erdhi keq kur e kujtoi këtë. Ai donte që vajza e tij të kish një emër të bukur, të pastër, thjesht shqiptar... ç'të keqe kish këtu? Pse të ziheshin ashtu kot së koti? Dhe i binte kazmës më thellë. Në ballë, gushë e fytyrë i rridhnin bulëza djerse, që bashkoheshin me pikat e shiut. Ai shkoi pëllëmbën pas zverkut dhe për një çast pushoi. Kish etje për ujë; ishte nxehur aqë shumë, sa uji që kish në shishe iu duk si i zier. «Dreqi ta marrë — mendoj — sa më pihet një ujë i mirë...»! Mendoj të shkonte në kodrën matanë, ku punonin arkeologët. Ish atje një burim i vogël me ujë të ftohtë, por deri atje mban-te disa minuta. «Kur të ha drekën do të shkoj — tha dhe vazhdoi punën. Por, sa uli krahët, kazma i ndeshi në diçka të fortë. Një si tingull metalik u ndie në thellësi të tokës. Astriti u bë kurreshtar, filloi të gërmonte më me ngulmë. Pas disa çastesh vendi u zmadhua dhe ai pa në fund një si pllakëzë të lëmuar. E mori shpejt nga gropa e vogël dhe filloi t'i hiqte baltën; ish një baltë

argjillore, e ngjeshur fort e që shkiste nëpër duar si dhjamë.

Filluan të shquheshin ca gërma që ai s'i merrte vesh. E la pllakën dhe filloi të gërmonte më thellë: gjeti aty përbri një diçka të vogël, të bukur me një trajtë të rrumbullakët, një stoli të vogël prej bronxi.

Astriti i mori të dyja ndër duar dhe s'po dinte ç'të bënte me to.

«Deshe, s'deshe, byrazer, do ta pish ujia e ftohtë që tani!» tha me vete. Qeshi dhe u nis për te arkeologët, që punonin aty prej disa muajsh. Astriti kish dëgjuar se ata po bënin kërkime dhe kishin përcaktuar banorët e hershëm të qytetit të Maliqit si edhe mënyrën e jetesës të këtyre.

Ai arriti tek ata dhe u tregoi ato që kish gjetur. Një burrë i gjatë dhe i shëndoshë e mori në dorë pllakën, e fshiu me kujdes, gjithnjë me emocion, me dridhje, pastaj filloi ta vështronte rreth e rrotull, duke çapluar sytë. Më në fund ngriti kryet dhe u mbush me frymë.

«Një pllakë varri! Qenka e një vajze të re... — dhe, duke e rrotulluar pllakën, vazhdoi: — ja edhe emri «Afrora», emër i bukur!»

Astritit i shkëlqyen sytë. Këtë s'e priste; iu hodh në qafë arkeologut pa e përmbajtur gazin: — Atëhere, vëllaçko, ti qofsh kumbar! — i tha dhe iku nxituar, duke e lënë arkeologun të habitur me pllakën prej guri në dorë.

EMOCION

Kaluan dhjetë muajt e kursit... viti i parë qëkurse dola në jetën e madhe të punës. Gjatë kësaj kohe vëzhgova, mësova, u stërvita duke mbështjellë e duke numëruar spirale me tela, llamba dhe shifra, kondensatorë me mikrofaradë... sa shumë emra të panjohur!

Më dukej se s'do t'i mësoja dot kurrë. Por këto kaluan. U ktheva në qytetin tim të vogël, hapë repartin e punës, vura tabelën «Reparti i riparimit të radiove». Vetë pastrova, vetë lava dyshe-metë dhe menjëherë më mbërtheu emocioni, një emocion që e ndjeva fort thellë por që është vështirë ta përshkruaj. Mendoja: «Kush vallë do të jetë klienti im i parë? Hajt, pra, kush? Shko dhe e gjej!»

Një dridhmë e lehtë tronditëse më bënte që të më skuqej fytyra e të më rrihte zemra fort. «Këtu — mendoja — jam vetëm; s'kam kë të pyes, as mjeshtër Llazon, as Petron. Këtu s'është më Mitati me shakatë e tij, me optimizmin e tij, me urratë e tij...»

Dita e parë kaloi e gjatë dhe në pritje. Më erdhën vetëm shoqet për të më uruar dhe kërkush tjetër. Më erdhi inat me ata të panjohur që s'po vinin tek unë. Por pastaj e mblodha dhe i mbusha mendjen vetes: «S'ka gjë, do të vij në nesër!»

Të nesërmen u ngrita herët. Qyteti ynë i ri gumëzhinte nga njerëzit, nga zhurmat e automobilëve, nga tingujt e muzikës, nga këngët e rinisë. Do të zhvillohej festivali folkloristik i zonës. Këtu ishte derdhur rinia e kooperativave bujqësore, veshur me fustanella të bardha shqiptare, plot vrull dhe optimizëm.

Dhe sa arrita në repartin tim, ja dhe klientja e parë. Ishte një vajzë pak më e madhe se unë, në moshë. Kish një plaçkë të mbështjellë me një mësallë të bardhë. E mirëprita me dëshirë, e përqafova me dashuri, bile e putha në të dyja faqet. Edhe ajo ishte e përzemërt nga natyra e saj; më pushtoi me dashuri e më rrahu supin me mirëdashje.

Më tha emrin, më tregoi se e dinte dhe timin, shtoi se ishte mami e re:

— Sapo mbarova shkollën, — tha. — Këtu po filloj për herë të parë punën. Ama s'kam ndihmuar ndonjë grua në lindje. Ç'ti bësh? Punë ditësh — dhe psherëtiu.

«Edhe ajo paska brengën time, një brengë që medoemos e provon tashti radhazi rinia jonë kur hyn në jetën e madhe të punës».

Vështrova nga bohça e saj. E çeli. Prisja të më sillnin një radio për ta ndrequr e më kish sjelellë një telefon. Po kjo?

— Na u prish mbrëmë papritur dhe na duhet

aty larg në fshat. Një urgjencë, një lindje e vë-shtirë... ku ta dish?

Një orë u kërrusa mbi aparatin, kontrollova fijet e kufies, fishekun e receptorit, tingullin e zi les... kur u hap dera.

Pra më sollën një radio? Ah, jo, s'qenka radio. Në vend të radios, një kooperativist plak kish sjellë një gramafon.

Përcolla maminë, i urova punë të mbarë, sukses. U përqaftuam e lidhëm fjalë se do të takohe-shim gjithnjë si shoqe të dashura, si vajza që ki-shim dalë në jetë në një kohë, si motra.

Kapa gramafonin.

— Na duhet sot, bijë; kemi dasmë e na duhet. Më duket se zembreku na u prish, se mbrëmë, kur pushoi së vërtituri, diçka i krisi në bark.

— Ashtu vërtet, xhaxho. Zembreku është kë-putur.

— Dhe do ta ndreqësh sot?

— Patjetër, xhaxho.

«Pa dale, si i shponte Petrua brimat në çe-lik? Duhet një kunjë e fortë, pak zjarr, duhet kujdes se zembreku t'i copëton gishtat e duarve».

Dikush hyri me rrëmbim në repart; mbante në duar një mirkofon. Ishte një inspektor shkollash, djalë i ri, me një fytyrë të shqetësuar.

— Shoqe, ju lutem, ju lutem shumë, mba-ruam, na u prish mikrofoni, festivali... Në Kor-çë nuk ka kohë të shkojmë. A do të na ndihmoni dot?

«Ah, ky s'paska besim tek unë. Po sot është dita e festivalit!»

— Po si ndodhi?

— Për dreq, duke marrë fizarmonikën në skenë, e shtyva pa dashur, ra e më s'punon.

«Plaku ka dasmë, inspektori nxitohet për festivalin. Nga t'ja filloj?»

Mbeta në mes të repartit me kolitir në dorë. Dhe kur s'dija nga t'ja mbanja, inspektori e plaku u muarrën vesh midis tyre.

— Dasmën e kemi në mbrëmje — tha plaku.

— Ne duhet të kishim filluar — tha djali.

* * *

Plaku do të ngjitet lart në malësi, në mbrëmje do të mblidhen dasmorët, do të këndojnë këngët e maleve, një gajde do të buçasë, djemtë do të hedhin valle, gratë do të këndojnë grarishte, do të ngrihen dolli për jetën e re, pastaj do të vënë gramafonin që të vallëzojnë. Dikush do të pyesë e do t'i përgjigjen:

— Na e ndreqi një vajzë e re, atje poshtë, te qyteti buzë lumit.

Pa dale! Një autoambulancë shket me shpejtësi në rrugën e asfaltuar. Iku andej nga kaloi mamia, shoqja ime e re. Mos vallë ndonjë lindje e vështirë? Ku ta dish? Ndofta edhe unë diçka bëra që qytetari më i ri i Republikës të lindë i fortë dhe i shëndoshë. Ku ta dish, ndofta! Dhe kjo parandjenjë, në mos qoftë e saktë, më gëzon. . .

Te sheshi i madh i qytetit të vogël, festivali ka filluar. Midis degëve të gjelbëra të shelgjeve lotonjës, midis currilave të shatërvanit, nëpër ajrin e kulluar, edhe unë vështroj arenën e festi-

valit. Një grup vajzash hedhin valle; vetë këndojnë, vetë vallëzojnë.

Sa dëshirë kam të jem midis tyre!

Zërat dëgjohen qartë, bukur. Pra mikrofoni punon për mrekulli!

Lart ushton një sirenë, fishkëllima del nga kombinati i sheqerit; është shenja e ndërrimit të turnit. Dalin andej djem e vajza me fytyra të përskuqura, të heshtura, se janë të lodhur nga temperatura e lartë... se, për të prodhuar sheqer të ëmbël, duhet shumë djersë. Po nxitohen të shkojnë në festival. Dikush më hedh një fjalë:

— Në orën 4 kemi provat e teatrit.

— E di, do të vij.

Por gjer atëhere unë do të rri këtu dhe përsëri kam emocion:

«Vallë kush do të më sjellë një radio?»

B A R D H A

D ita po thyhej dhe qielli i ngjante një pël-hure në ngjyrë të hirit që vende-vende i ka dalë boja. Ca re të murme ndiqnin shoqja-shoqen, dukeshin sikur lëpinin njëra-tjerën dhe nga ana e perëndimit po ngjyheshin me të kuq.

Një vajzë e re, e panjohur atyre anëve, po hynte në fshat; mbante një valixhe që dendur e kalonte nga njëra dorë në tjetrën dhe vështrimi i saj po përpinte me kureshtje gjithshka që shihte përreth. I bënin përshtypje shtëpitë prej guri ngjeshur njëra pas tjetrës, muret, ku ishin varur vargje me duhan e pipere të kuqe, rrugët e ngushta me bar për anash dhe kumbullat e egra që, të ngarkuara rëndë, vareshin përmbi rrugë. Gurët e udhëve ishin kruar e lëmuar nga zinxhirët e traktorëve, aty-këtu ndiheshin zhurmat e tundësetvet që rrihnin bulmetin dhe për çudi, nëpër fshat, kish fare pak njerëz. Por Bardha e mori me mend se ishte kohë pune dhe doemos njerëzia ishin derdhur arave dhe fushave. Vajza akoma po nanuriste ëndrrat e veta dhe përfytyronte se në kë-

të apo në atë shtëpi do të priste fëmijën e parë, në atë më tutje do ta thërrisnin mu në mes të natës. «Mami, o shoqja mami! shpejt se nusen e Likos e kapën të prerat!» Në atë shtëpinë përfundi rrugës do ta zgjidhnin edhe për nune dhe Bardha do t'i vinte emrin e parë «Gëzime»! «Të rrojë sa malet!»

Vajza qëndroi diku në mes të fshatit, afër një pusi; mbi plloçat afër tij po trokiste këmbët një kalë dori, që pinte ujë në postaf duke u gëlltitur me gllënka të mëdha. Mbi pus ishte një arrë e madhe me hije të rëndë dhe nën hijen e saj rrinin tri plaka. Ato i çukitën kokat njëra-tjetrës kur panë vajzën e re dhe të panjohur dhe diçka murmuritën midis tyre.

Bardha u foli dhe u dha dorën të trijave, por ato s'deshën ta linin të ikte pa marrë vesh më parë cila ishte, për ku ishte nisur, prej nga vinte dhe përse vinte. Vajza e re u tregoi dhe ato ja ngulën vështrimin në sytë e saj ngjyrë lajthie dhe në fytyrën e freskët që sapo ishte përcëlluar nga dielli.

— Po ti, çupërlinë, do të ndihmosh nuset tona?

Bardhës iu duk sikur i hodhën në gushë një kovë me ujë nga të pusit aty pranë.

— Ç'ka për t'u çuditur këtu, moj gjysheni... Unë jam mami, kam mësuar kaq vjet në shkollë. Më kanë dërguar tek ju...

— Po ti, moj bijë, ke lindur vetë ndonjë herë?

— Unë?

Ajo u përskuq në fytyrë dhe picërroi sytë.

— ... Po unë jam vajzë...

— E... po kur je vajzë, ç'do atëhere?

— S'e di ti se ajo që s'ka gatuar kulaç ndonjë herë...

Vajza nuk dinte se çfarë t'u përgjigjej dhe ngriti supet.

* * *

Në shtëpinë e Ganiut e pritën mirë. Në oborr dolën dy nuse me fëmijët e vegjël në krahë, bile njëra, që i jepte gji foshnjës, me njëren dorë shtrëngoi vajzën, kurse krahun tjetër e hodhi mbi qafë të Bardhës.

— Mirë se na ardhe dhe me këmbë të mbarë!

U ngjitën lart në odën e zjarrit. Nëpër qoshet e tavanit kishin varur kokrra mollësh, kurse mbi buhari kishin vendosur tre-katër forma të bukurra të gërshtuara kallinjsh gruri. Bardha dëgjoi të zihej në gojë emri «Tixhe», kuptoi se kjo ishte vajzë e shtëpisë, e mori me mend që emri i Tixhes zihej në gojë, sepse parashikohej që Tixhja do të ishte shoqe, shoqëronjëse apo moshatare me Bardhën. Po, si dukej, Tixhja ishte larg.

— Po cila është kjo Tixhe? — guxoi dhe pyeti Bardha.

— Kunata jonë. Është goxha çupë, do ta kesh krah. Sot ka shkuar larg me brigadën e tretë, në arat e malit.

Me ardhjen e natës u bë më fresk, pastaj ajri u ftoh dhe, padashur, Bardha fërgëlloi dhe i shkuan të ngjethura.

2767 ~~32719~~

— Vend malësi këtu — foli njëra nga nuset,
— gusht e gunë...

Dhe qeshi sa iu bënë dy gropëza ndër faqet. Por nusja tjetër, ajo më e holla dhe që mbante një çember të kuq mbi kokë, ja lëshoi kunatës edhe fëmijën e saj dhe rendi tatëpjetë shkallëve. E ulur në një minder leshti me një jastëk të gjatë e të trashë në shpinë, Bardha mori fëmijën e dytë dhe e mbajti në prehër. Ishte një djalë nja shtatëa tetë muajsh, me flokë gështenjë të çelur, me një fytyrë të trëndafiltë e të ndritshme dhe me një palë sy aqë të bukur sa nusja u shqetësua.

— ... i ka të bukur shumë, mos ma merr për keq, por... thuaj mashalla... ngjet nga fisi i sime kunate. Ata i kanë sytë mavi, por ky i ka më shumë se ata...

— Është njomzak; është akoma në sisë; kur të rritet nuk do t'i ketë kaq mavi po shumë të bukur, shumë.

Bardha ndehu përpara djalin e vogël dhe ja vështroi sytë nga një largësi më e madhe. Por befasi diçka iu kujtua:

— Dhe ju e paskeni vajzën si tufë lule...

Bardha do të fliste akoma, kur u dha në derë nusja me tenegenë e madhe të furrës ndër duar. E kishte të mbushur plot me prush. U ul në gjunjë te vatra, derdhi në kllanik thëngjijtë e kuq dhe trazoi urët me mashë.

Poshtë ndiheshin çape burrash dhe copëza bisede:

- Nga ishe ti sot?
- Vadita patate te Përroi i Madh.
- Vahitin e kafshoi një grerë.

— Fërkojani vendin me uthull.

— Tixhja do të vonohet. Shkuan për mbledhje në sektorin e Dëllinjës.

Dhe pasi hëngri darkë me nuset e shtëpisë, dhe pasi priti më kot të dukej në odë ndonjëri nga burrat e shtëpisë, dhe pasi kot e më kot priti Tixhen e panjohur, Bardhës iu afrua gjumi. Zuri të kotej, kaqë herë fërkoi faqet me duar, u mundua të mundte gjumin, por s'ja arriti dot. Nuset e reja sollën aty një dyshek, shtruan një jorgan, që dukej fare i ri, i uruan natën e mirë dhe shkuan.

Por vajzës iu duk sikur gjumi iu largua dhe përsëri filloi të ëndërronte: I dukej sikur rreth saj silleshin nuse të reja, që i kërkonin këshilla, ndonjëra s'ishte e sigurt dhe me gishtat e duarve numëronte ditë e javë... Ëndërronte veten e saj të gëzuar kur jepte sihariqin: «Çupë e bukur, si lum ju, të na rrojë!» «Djalë! djalë! do të bëhet trim dhe i fortë».

Dhe ëndërrimi i saj vazhdoi akoma dhe ajo nuk e kuptoi dot kur mbaroi ëndërrimi me sy të hapur dhe kur filloi ëndërrimi me sy të mbyllur dhe u thellua në gjumë.

Kur u zgjua, dita ishte hapur fare. Nuk e kuptoi në u zgjua vetiu apo nga disa çape të drojtura, që silleshin në tremën e madhe të shtëpisë. Pastaj menteshet e derës kërcëllitën lehtë dhe kanati u hap fare pak. Nëpër atë si shirit të gjatë e të ngushtë Bardha dalloi një palë sy të butë e të zez, pastaj një gërshet të trashë të varur përpara; u çelën një palë buzë në një fytyrë zeshkane dhe një zë i panjohur, u dëgjua:

— Mirë mëngjezi shoqe!

Bardha kërceu nga rrobat dhe prej vetiu rrëmbeu fustanin e vet të froni afër dhe e vuri mbi vete si për t'u mbuluar, po kur nuk pa njeri tjetër pas vajzës, lëshoi fustanin përtokë dhe ndehu para duart ashtu si po bënte Tixhja.

— Mirë mëngjezi, Tixhe! Ti duhet të jesh... më folën shumë për ty.

* * *

Ndryshe e pat menduar Bardha punën e saj, krejt ndryshe e pat ëndërruar fillimin dhe tashti po i dilte përpara një çështje e papritur. Ajo s'i mbushi dot dy ditë në shtëpinë e Tixhes dhe, megjithëse njerëzit e atyshëm mundoheshin të fshiheheshin prej saj, e kuptoi se përbrenda asaj familje po ziente një sherr i vërtetë. Brenda dy ditëve Bardha mësoi çka ndodhte dhe tashi i dukej sikur ishte njohur me Tixhen që prej më shumë se një viti. Vajza e re i tregohej se donin të celebronin martesën e saj me një njeri me të cilin e kishin fejuar që të vogël. Ai nuk ishte njeri i keq, po ja që Tixhes nuk i pëlqente dhe ky mospëlqim ndofta vinte nga se asaj i pat hyrë në zemër një djallë i ri aty në fshatin e saj, i pat hyrë në zemër Qemali i lagjes matanë, ai Qemali korozi e mustaqespicë që, kur e lëshonte zërin për këngë nëpër ara e nëpër pllaja, dëgjohej gjer brenda në fshat, e bile gjer në kthinën e Tixhes vetë.

Kështu ndodhi me Tixhen ajo që, tashti nëpër malësitë tona ka marrë radhë. Tixhja, pasi u mundua më kot t'u kundërshtonte burrave, gjyshit dhe babait, pasi u mundua më kot të kishte krahun

e nuseve, çuçuriti vesh më vesh net të tëra me Bardhën dhe ja, një mbrëmje herë, kur të gjithë ktheheshin nga puna, Tixhja me bel në krah nuk u kthye më në shtëpinë e saj, por shkoi bashkë me Qemalin.

Kjo ngjarje i tronditi fort të mykurit e fshatit. Bashkë me mallëkimet e pleqve e të plakave për Tixhen, të tjera mallëkime dhe sharje dëgjo-heshin edhe kundër Bardhës.

Bardha u detyrua të ikte nga shtëpia, ku kish ndejtur që natën e parë dhe shkoi në shtëpinë e re të Tixhes. Por fjalët e të mykurve e ndoqën pas.

— Iku nusja e mori pas edhe vleskën e re!

— Po të mos e nxitte ajo e qytetit, Tixhja, as bente çap prej shtëpie!

— Ajo kuçkë do na prishë terezinë e fshatit!

— Sakën se e thërrisni në lindje e në...

— Mos t'i lënë nuset në dorë të saj, se ajo s'ka haber!

— Në vend të kërthizës, fëmijëve do t'u çajë barkun ose do t'u presë kokën.

— Do t'i shtyjë vajzat që të mos u lajnë këmbët burravet.

Kishte burra dhe djem në fshat që e afronin në bisedë, që flisnin pa të keq me të, kurse Qemali vetë fliste më i shkujdesur.

— Kështu është fillimi, shoqe, mos u tremb ti, ka rrjedhur ujë, kanë ndodhur ndryshime të mëdha këtej. Të kish qenë një kohë tjetër, në fshat do të kishte krisur pushka, po mos u mër-zit, as zogu s'e ka të lehtë të ngrejë folenë e vet.

— Po mirë, o shoku Qemal, e kuptoj, e di,

ke të drejtë, po si t'ja bëj unë? Që kur erdha kanë ndodhur tri lindje në fshat dhe në asnjërën s'më kanë thirrur...

— E di fare mirë. Ne e kemi bërë çështje në organizatë. Shokët kanë marrë përsipër dhe, në fund të fundit, ta thotë Qemali ty... pastaj, më fal shoqja Bardhë por unë do të të thërres ty, do të të thërres patjetër...

Bardha uli sytë dhe murmuriti.

— Ju talleni, shoku Qemal!

— Jo, jo, nuk tallet Qemali, unë flas hapur dhe troç! Dhe një gjë ta dish ti. Diç kam mësuar atje në ushtri, ta thotë Qemali ty, ka thënë Suvorovi: «S'ka fitore pa luftë e pa vështirësi». Ta kanë nevojën ty, mos u nxito. Kur i zë e lindura gratë, vjehrrat dhe kunatat s'dinë nga t'ja mbajnë.

* * *

Por edhe katër lindje të tjera ndodhën në fshat dhe Bardhën nuk e ftoi njeri.

Tri lindje ajo s'i mësoi dot fare, por të katërtën e mësoi dhe deshi të hynte vetë. Deshi, por e gjeti portën mbyllur dhe që prapa portës dëgjoi disa kanosje prej një zëri plake. Bardhës i shkuan lotët për faqe dhe iku tatëpjetë. Sharje të atilla s'kishte dëgjuar kurrë në jetën e saj.

Dhe ja, sapo mësoi një lindje të re. Nuk e mësoi vetëm ajo, por i tërë fshati. Në qetësinë e një nate të zezë vjeshte Bardhës i erdhi deri në kthinën e saj klithma e një rënkimi të fortë. Dhe pikërisht duke dëgjuar përsëritjen e këtij rënkimi, iu duk sikur ai nuk ishte rënkim, por një thirrje,

një ftesë, një lutje. I dukej sikur Selimeja e varfër me buzë të kafshuara, të gjakosura, e shante, e quante të pazonjën që nuk dinte të çante terrin e natës dhe të thyente llozin e rëndë që plaka i shkonte portës.

Ajo u vesh shpejt e shpejt, ndezi edhe një gazanik që kishte mbi buhari dhe shkoi te dera, ku flinte shoqja e saj:

— Tixhe!

— Urdhëro!

— Vishu dhe eja me mua, Tixhe, të kegen...

Tjetra kuptoi që buzët e Bardhës dridheshin.

U vunë në rrugë; iknin tatëpjetë dhe mamia e re shtrëngonte mbi gjoks çantën me veglat e veta. Kishte vendosur të hynte patjetër gjer te gruaja, që përpëlitej e s'lindte dot. Por sa iu afruan shtëpisë, vunë re se s'ishte e lehtë të hynin brenda. Mu përpara portës, ulur mbi sofatet e gurta, rrinin burrat e shtëpisë, nuk flisnin as pipëtinin, por mbanin kryet ulur.

— Ti, Bardhë, mos dil, fshihu këtu pas gardhit!

— Jo, nuk fshihem unë...

— Po ti dëgjomë mua, dale, ti qëndro këtu; dale ta marrim shtruar një herë.

Tixhja u doli përpara burrave:

— Ju lutem shumë, në mos e ndihmoftë Bardha Selimenë, keq s'ka për t'i bërë. Le ta thërresim një herë, të marrim një mendje. Pushteti dhe partia që e kanë dërguar... Ajo po pret ja, aty..

Por gjyshi i shtëpisë nuk e la të mbarojë.

— Unë s'të lë as ty të kallësh këmbë ndër ne e jo atë zuskë. Hajde, shporru, mos të t'i shoh sytë!...

Tixhja iu kthye plakut aty për aty:

Bardha donte të hapte rrugë, të pushonte klimtat e dhëmbjes së Selimesë, ajo donte të thyente paragjykime dhe mendime të mykura, por plakun me llullën ndër dhëmbë as begeniste ta vështronte në fytyrë Tixhen. E përhumur para një porte, që s'donte të hapej, Tixhja nuk vuri re se nën pezulet e gurta, andej nga e djathta, ku kalonte rrugica për në bahçe, një nuse e shtëpisë u vodh e rendi përperjetë. Nusja pat dëgjuar se Bardha priste atje afër dhe nuk vonoi ta gjente.

Kur Bardha u dha në derën e lehonës, katër plaka, si katër poçe të zeza, po vërtitëshin rreth Selimesë. Kësaj nga buzët i rridhte gjak dhe sytë i ishin zmadhuar. Mbi ballë i genë shpërndarë flokët ngjyrë gështenjë dhe dukej sikur djersa, që i derdhej sumbulla-sumbulla mbi fytyrën e zbehtë, i rridhte nga flokët. Mbi fronin afër, Bardha vuri re disa alipsane, një hajmalë të madhe, bile dhe një ikonë kishe. Bardha iu vu punës dhe nuk vonoi e fëmija ra. Gratë klithën të tmerruara. E vjehrra e Selimesë përpiqte duart mbi gjunjë. Fëmija ishte i gjallë, por ato s'ishin të sigurta a do të rronte. Edhe dy fëmijë të tjerë pat lindur kështu Selimeja dhe pas disa çastesh jetë i kishin vdekur. Duhej vepruar shpejt se ishte rrezik që fëmija të mbytej nga ujërat e tepërta. Tirolet nuk kishte, por nxori një garzë dhe ja vuri fëmijës mbi buzë me buzët e saj filloi t'i thithte ujin.

Djersët e Bardhës binin mbi gjoksin e foshnjës, fytyra i kishte marrë zjarr dhe nga të thithurat asaj iu ngritën dy damarë të trashë mbi gushë. Ajo thithte dhe nëna e mjerë, e dërmuar

nga lodhja e nga dhëmbjet, belbëzoi ngadalë:

— Të keqen, motër, shpëtoma...

— E ke vajzë. Ua sa vajzë e bukur!...

— Le të jetë çfarë të jetë, por shpëtoma...

Tashti Bardha thithte ujë nga foshnja dhe lëshonte mbi të lot gëzimi. Trupi njomzak filloi të merrte ngjyrë trëndafili, në krye foshnja bëri një farë ngërdheshje dhe pastaj u dëgjua një piskamë e gjatë dhe e mprehtë!

Bardhës i shkuan të ngjethura në trup, gjer në thembrat e këmbëve. E ndjeu veten të lumtur. Ajo piskamë e mprehtë dhe e fortë do të shembte mendime të mykura, ajo piskamë e fortë do të thyente lloza të vjetër portash! Ajo po fitonte.

ATË E BIJË U KUPTUAN

Në qytet u ndezën dritat e fundit, ato të rrugicave të vogla. Ishte një mbrëmje vere, një nga ato mbrëmje kur të duket se gjithshka llamburit nga drita e qiellit, e pastër, e bukur, e ngroh-të.

Në katin e fundit të apartamentit të madh, u shua një dritë e, mbas disa çastesh, u ndje një zhurmë e lehtë te shkallët e gurta.

— Besa, po pse me këto sandale, pse nuk mbathe këpucët?

— Jo, jo nënë, të mira, shumë të mira i kam këto, të lehta, të bardha, s'ka si bëhen më të mi-ra...

— Mos u vonuam? Po sikur të ketë filluar?

— S'më besohet. Si do ta fillojnë para kohe?

— Pastaj pa ne...! — tha gjysmë me kre-nari e gjysmë me shaka e ëma.

Dhe ëmë e bijë, duke biseduar e të kapura krah për krah, hynë në sallën e madhe të kino-klubit. Ndjeheshin zërat gazmore të punëtorëve, të të ftuarve dhe salla e madhe gumëzhinte. Lart në tavan abazhurët e mëdhenj me zinxhirët e

verdhë lëshonin një dritë të bukur, duke u dhënë shkëlqim globeve prej letre e shiritave të ndritshëm prej celofani.

Besa e ndjeu menjëherë atmosferën e ngrohtë e të gëzueshme të festës. Ajo u rrëqeth pakëz dhe e shtrëngoi të ëmën prej krahu.

— Shiko, mama, shiko sa bukur e kanë zbukuruar sallën!

Në çast një melodi e ëmbël sikur i elektrizoi të gjithë. Si duket, ata të orkestrës, të futur prapa perdeve të rënda të skenës, përgatiteshin për mbrëmjen e vallëzimit. Dalëngadalë edhe ata që rrinin e bisedonin më këmbë, duke pirë duhan, zunë vendet e tyre.

Besa me të ëmën u ulën në rreshtin e parë të karrigave. Që aty Besa kalonte vështrimin tek ata që rrinin në presidium.

«Xha Nasi, mjeshtëri i sheqerit... Rafaeli, punëtori më i ri vakumit... Po ai tjetri cili është? S'e njoh, s'e kam parë ndonjëherë në qytet; ku ta dish, ndonjë i ftuar. Syrjai, kryetar i bashkimeve profesionale të kombinatit, babai i punëtorëve, si e quajnë me shaka, ja, pas tij im atë...»

Besa kafshoi buzën ngadalë dhe uli sytë përde, nuk deshë t'ja takonte vështrimin t'et, ndonëse në shpirt një ngrohtësi e çuditshme dhe një dhëmbshuri e pushtoi për të, për të pesëdhjetë vjetët e tij.

Ajo e kaloi përsëri vështrimin andej. Në krah të t'et ish një grua,

«Kryetarja e komitetit... punëtorja pensioniste Leni... drejtori i shkollës».

— Shokë, — dëgjoi papritur Besa, por nuk e mblidhte dot veten të dëgjonte ato që thoshte Syrjai, mjeshtëri i sheqerit, ai që e kish gjoksin plot dekorata nga lufta për çlirimin, nga beteja për tharjen e kënetës, nga përpjekjet për ngritjen e kombinatit, nga puna e pandërprerë për t'i dhënë sheqer gjithë Shqipërisë.

Ajo përsëri ndeshi vështrimin e qetë e gazmor të t'et e nuk deshi ta besonte se ai mund të ish tjetër njeri. Ato thinjat e bardha rreth tëmthave ja fisnikëronin gjithë qënjen, ajo buzëqeshje e ëmbël s'mund të mvrejtej kurrsesi në fytyrën e tij.

«Vërtet, ta ketë me gjithë mend babai?»

Besës iu kujtua biseda që kish pasur me t'anë.

— Ç'të duhet shkolla ty, Besa, gjimnazin e mbarove, tani për një vit ose, e shumta, dy, të del fati. Do të qetësohemi edhe ne.

— Si!?

Besës i qe mbledhur një lëmsh në grykë. Këto fjalë i kishte dëgjuar rastësisht edhe dy ditë më parë, vjedhurazi, ndërsa i ati bisedonte me t'ëmën.

Por Besa i kalonte ndër mend, si nëpër mjer-gull ato fjalë. I dukej sikur i kish dëgjuar në një kohë të largët, sikur ato dy ditë të mos kishin ekzistuar kurrë. As e kish menduar se do t'i dëgjonte përsëri «nuk e lëmë, do të na priset andej, pastaj e kemi të vetme, kur do t'ja shohim hajrin.» Ishite e ëma ajo që fliste kështu dhe ai, babai, i aprovonte me një «mirë e ke» fjalët e saj.

— Baba, si kështu? Mosni, mos më ndani nga shoqet.

— Janë katër vjet, moj Besa. Si do të rrimë vetëm, mendo edhe për ne. S'e mos kemi fëmijë

të tjerë dhe nuk të lamë! — i fliste e ngashëryer e ëma — babai ka të drejtë.

— Si kështu, si? — përsëriste Besa herë pas here — si kështu? Kaqë vjet kanë kaluar nga koha kur kishe të tjera mendime, tani... Më duket se ti, baba, i di më mirë se unë këto. Për këto probleme janë thënë sa e sa fjalë, janë shkruar sa e sa libra, edhe ti i ke lexuar, ndoshta u ke dhënë të drejtë autorëve, po për veten tënde, për fëmijën tënd të janë dukur «gogol»! .

— Ouh, mjaft na çave kokën...

— Baba!

— Ja, kështu si të them unë.

Dhe nuk kishte folur më. Nuk donte të fliste, ndonëse në disa çaste (këto çaste i mbyste shpejt frika për fatin e së bijës) i jepte të drejtë asaj. Por mendonte: «Do t'i kalojë shpejt, edhe ajo do ta ndjejë veten më mirë pak më vonë. Kur të shohë shoqet që t'ja mbathin për në fshat, do t'i vijë mirë që është në vatrën tonë.»

Por edhe këtu, në këtë arësyetim, kishte disa çaste kur ai ndjehej keq.

«Unë luftova maleve, fshatrave, e tani Besës sime t'ja neverit ato? Pse? Si është në fshatra?»

Por shpejt i largonte këto mendime. Druante. Druante se mos ato ja paralizonin krejt gjykimin e ai do të nxitohet të jepte një vendim «të padrejtë».

— Pesëdhjetë vjet i mbushi shoku i ynë, — dëgjoi Besa. Akoma po fliste «babai i punëtorëve». Ai fliste e herë vështronte aty në tavolinën e presidiumit, herë në rreshtin e parë e buzëqeshte lehtë. — Pra, pesëdhjetë vjet i mbushi, por ai

s'është plak. Doemos as i ri (e Syrjait i shkau buza në gaz), por zemrën e ka të re, mendimet të reja, shpirtin luftarak, energjitë të reja... Në luftën partizane ai shkoi i pari. Pas e ndoqi një vajzë e re atëhere, Lumtëri Rexha, sot bashkëshorte e tij. Pas lufte u martuan këta njerëz të revolucionit; këta njerëz të klasës, këta...»

Lumtërisë i shkojnë lot, i shoqi është hutuar, kurse Besës i dridhen buzët. Vajza po mrekullohet. Sot po merr vesh diçka të largët, që s'e dinte. Në ato çaste mallëngjimi sikush donte të thoshte një fjalë, t'i shprehte Skënderit një urim. Çudi! Të gjithë i kish rrëmbyer entuziazmi, emocioni!

— Në mal e kam njohur edhe unë Skënderin — fliste Spirua, një plak i gjatë, me trup pak të kërrusur e me një fytyrë të hequr e të rreshkur nga dielli — ishte trim, por edhe Lumtua gjak në vetull të merrte, na e kalonte nganjëherë edhe ne burrave, apo e kam gabim, o Skëndo...?

Ai qeshte. Të tjerët e dëgjonin, qeshnin edhe ata e Skënderi nga mallëngjimi s'i ngrinte dot as sytë. E dinte që ata do ta trathtonin, se lotët i ndjente nën qepallë.

— Kush e do fjalën? — drejtori ngriti sytë nga salla. Besa këceu nga karriga. E ëma me lot në sy e vështronte nga koka në këmbë. I ati, me qerpikë të ulur, sikur kërkonte diçka të vizatonte, ca rrathë të ngatërruar e pa kuptim mbi bezen e kuqe të tryezës së madhe.

— Ju falemnderit për nderin që i bëni babait, ju falemnderit shumë. Për mua, për mëmën dhe për babanë... (ajo vështroi nga i ati, deshë t'ja takonte vështrimin, pa të vijonte) kjo do të mbe-

tet dita më e shënuar në jetën tonë e për mua në veçanti dita më e lumtur. Sot unë mësova diçka të bukur. Babai im ka qënë përparimtar që në fillimet e revolucionit, ai kurrë s'ka pasur paragjykime për femrën, ai që atëhere ka dalë në mal me...

Besa u mallëngjye. Nuk fliste dot. Dikush që nga mesi i sallës e plotësoi mendimin e saj:

— me mamane... .

Në sallë filluan bisedat. Njerëzit duartrokitën. Të gjithë vështronin të bijën e Skënderit. Vajza heshti për disa çaste. Për atë që do të thotë duhet të mendohet mirë, duhet të matet, një fjalë e saj tani, e turpëron babanë në sy të gjithë qytetit, në një ditë kaq të bukur për të. Ajo përsëri vazhdon; flet me zë të dredhur:

— ...por babai im, sot, pas kaq vjetve...

Skënderi i mallëngjyer, turbullohet, kërkon diçka t'i thotë vajzës, kërkon t'i bëjë një shenjë. Është kaq i hutuar dhe i shqetësuar sa të gjithë e vënë re se ai diçka ka dhe Besa diçka fsheh.

Po. Por Besa pa diçka në sytë e babait pesëdhjetë vjeçar. Iu duk sikur kumboi e tërë salla. Dhe qëndroi një çast. Po kush më shumë se vajza mund të lexojë sytë e babait? E kuptoi, e ndjeu:

Ai në tryezën e presidiumit, ajo në rreshtin e parë, atë e bijë u morën vesh, u kuptuan.

AJO DHE TË DY SHOKËT

Kishte ardhur vjeshta. Përanash xhadesë së madhe plepat e lartë dukeshin më krenarë, më të bukur, se ndër ato ditë, fët e fët e si pa kuptuar ndërruan veshjen e gjelbër dhe fletët muarën ngjyrën e verdhë të portokallit. Koha ndërronte fytyrë aty për aty. Këtu dukej dielli një copë herë, pastaj retë dyndeshin mbi njëra-tjetrën e ja niste një shi i hollë vjeshtor, që sitej butë-butë mbi kërcëjtë e lakrave, mbi kokrrat e kuqe të mollëve dhe mbi barin e gjelbër e të hollë. Asfalti ndrinte dhe makinat nxitonin gjithnjë, herë një kolonë e gjatë, herë një veturë e vetme, pastaj një «gaz». Një çiklist mundohej të kalonte nën mbrojtjen e plepave për t'i shpëtuar shiut.

Papritur autobusi ynë frenoi. Udhëtarët nxituan pas xhameve. Unë e fshiva avullin nga xhami me mëngën e palltos. Në mes të xhadesë tre oficerë të policisë rrugore me rroba blu, me ballin të ngrysur, seriozë, që silleshin, matnin, fotografonin, hidhnin vështrime aneqark... Dy Zisë kishin qëndruar në rrugë, njëri me rrotën e parë futur në hendek, më tutje dy-tre veta për-

kujdesnin dikë, si dukej, ndonjë të plagosur. Me siguri kishte ndodhur një aksident, dhe të dy shoferët...

* * *

Ata dikur kishin qenë shokë. Kishin lindur dhe ishin rritur në një lagje, bile në një rrugë. Ishin rritur afër e afër, pastaj kishin shkuar për shërbimin ushtarak dhe qenë kthyer me patentat e shoferit në xhepa. Sami e quanin shoferin e qetë, që tashti po rrinte pikë e vrer në mes të rrugës, kurse tjetrin, që po e mjekonin aty në mes të arës, midis perimeve, Bardhyl.

Kishte ndodhur ashtu sikurse ndodh shpeshherë në jetë. Dy djem ishin dashuruar pas një vajze. Vajza ishte e mirë, shumë të mirë ishin edhe të dy djemtë, por me doemos Elda vetëm njerin prej tyre do të zgjidhte. I pëlqeu më shumë Samiu, ndofta për natyrën e tij të qetë, të çiltër dhe bujare. Pastaj erdhi dasma dhe dashur padashur edhe prishja midis të dy shokëve. U munduan shokët e tjerë të parkut, u përpoqën më kot natën e dasmës që të sillnin aty edhe Bardhylin, por më kot.

— Lermëni, — përsëriste ai i vrerët dhe i mërzhitur, — lermëni, nuk mundem të vij; më kup-toni, shokë, këtë e bëj kundër arësyes, por ja që nuk mundem të vij, lermëni...

Dasma vijoi deri në mëngjezin e së hënës. Pastaj filloi jeta bashkëshortore, përpjekjet për të siguruar një banesë tjetër, hyrjedaljet në këshillin e lagjes, vajtje-ardhjet në komitet, dhe një vit më

vonë Samiu, duke shkelur rregullin, hyri me Zisin nëpër rrugët e lagjes, futi në kabinë Eldën dhe me një frymë e çoi në maternitet. Në familjen e Samiut u shtua një vajzë e vogël dhe shoferi s'e bëri të gjatë, por e fotografoi të bijën ashtu, siç ishte në mes të pelenave të bardha dhe atë fotografi e vuri në një kornizë, kornizën e vari para syve të vet në kabinën e «Zisit». Përfund fotografisë shkroi me gërma të mëdha «Babi, mos u nxito në rrugë. Babi, ki kujdes, unë dhe mamaja të presim!»

Samiu, i qetë si gjithnjë, jepte e merrte me timonin ndër duar. Llërët e tija të thekura nga dielli, përkëdhelnin timonin e lëmuar, kuklla e bardhë, një arushe prej beluzi, e varur në një fije llastiku, lozte valle mbi fotografinë e vogëlushes. Ai mbarte panxhar për kombinatin e sheqerit, por atë vit, qëkurse ishte bërë prind, punonte më me qejf dhe, duke e pasur mendjen gjithnjë te vajza e vogël, i vinte mirë të përfytyronte se pikërisht nga po ai panxhar që mbarte, të dilte sheqeri me të cilin Elda do të gatonte lllapatë me oriz për vajzën.

Shiu binte i hollë dhe trokëllinte mbi fletët e plepit, ujërat rridhnin me zhurmë dhe mblidhnin lëmashk nëpër rrënjët e barit. Zisi hungronte ngadalshëm e dëgjohej në rrugë ajo fëshfërimë e vazhdueshme e ujërave të pakta që çonin rrotat e automjetit. Samiu i buzëqeshte së bijës; pastaj për një çast mblodhi hundën dhe me gishtin tregonjës goditi arushën e bardhë, që filloi një valle edhe më të nxituar.

Zisit të Samiut po i afrohej një Zis tjetër. Në

këtë ishte shofer Bardhyli, shoku i dikurshëm i Samiut, ai që tashti sa herë takonte në rrugë Samiun, ose ndërronte drejtim, ose kthente kryet gjetiu, ose, kur ndodheshin ballë për ballë, ulte kryet dhe fytyra i merrte zjarr si prej një farë turpi që as vetë s'ish në gjendje ta shpjegonte. Edhe këtë herë, kur Bardhyli njohu përpara targën e Zisit të Samiut, iu duk sikur diçka e goditi në bark.

«Ja ai (Bardhyli nuk i vinte mbarë t'i zinte emrin në gojë, qoftë edhe me mendje), ai që më rrëmbeu atë. Po çfarë t'i bësh, ajo atë zgjodhi; por edhe sikur ai, edhe sikur ajo të kenë të drejtë, mua më djeg, më përvëlon akoma, s'mundem ta gëlltit atë turp. Atëhere të gjithë thanë: «Elda e la, e neveriti Bardhylin». Dhe ky më shkon përpara krenar, tashti e mban edhe hundën ngritur: Domosdo, u bë baba. E nget kamionin ngadalë, sikur e ka traktor, dhe thonë se në kabinë mban fotografinë e së bijës, po po, kështu thonë. Hej drej! Po ti, kapedan, desha s'desha unë, në jetë ece përpara meje, por këtu, në rrugë, këtu në punë, ti s'mund të ma dalësh mua, jo, jo. Unë s'të lejoj!»

Bardhyli ndërroi marshin, shkeli gazin dhe, pa lajmëruar fare, deshi të kalojë Zisin që kishte përpara, Samiu u ndodh ngushtë, u gjend në një çast të papritur, sepse pikërisht aty rruga ngushtohet mjaft nga një kanal i nëndheshëm, që priste xhadenë. Samiu deshi të manovronte, deshi të hapte rrugë, por, si duket, edhe Bardhyli në atë çast aqë të shkurtër e kuptoi që ishte nxituar tej masës dhe u mundua të frenonte. Frenat kërcitën, por rruga që e lagët, asfalti i lëmuar dhe Zisi

i Bardhylit lëshoi një fishkëllimë e rrota e parë mbaroi në hendek. Bardhyli e humbi toruan dhe. në atë të papritur, fare instinktivisht, çeli derën e kabinës dhe u hodh përjashta... Bëri një kollo-tumbë. Diçka e pickoi në shpatull, kurse fytyra iu ngjesh në baltën e arës...

Ja, ky ishte aksidenti, kjo qe ngjarja e asaj dite në mes të xhadesë. Pastaj oficerët me rroba blu, mbajtën procesverbalet, pyetën shoferët, në fillim veç e veç, pastaj i afruan dhe pyetën së pari Samiu në sy të Bardhylit:

— Sipas mendimit tuaj, kush e kishte fajin?

— Unë, — u përgjegj qetë-qetë Samiu, — ai i ra borisë, por unë nuk i hapa rrugë, ose, më mirë të them, i hapa, po pastaj s'e pata mendjen dhe e ngushtova përsëri daljen e tij... dhe kë-shtu...

Samiu nuk foli më tepër. Bardhyli uli kryet, kurse njëri nga oficerët shkruante me nxitim mbi letër. Dhe në këtë çast Samiu iu afrua Bardhylit dhe i tha:

— S'ka gjë, do të kalojë, po... nuk më thua... a të dhëmb shumë vendi këtu ku u godite, te supi..

Tjetri psherëtiu thellë dhe nuk ja ktheu vësh-trimin shokut që po ja kërkonte me sy, pastaj murmuriti ngadalë:

— Plaga që mora nuk më dhëmb, më shumë më rëndon e më dhëmb diku më poshtë nën plagën...

Njëri nga oficerët mbylli dosjen, ngriti dorën lart dhe urdhëroi që të çelej trafiku. Samiu nxo-ri kavon e tij të çeliktë, e kapi te gremçi i ma-

qinës së Bardhylit, hipi në kabinë dhe e nisi kamionin e vet duke vështruar prapa, duke tërhequr shokun e tij të dikurshëm që tashti, i menduar e i heshtur, mbante timonin vetëm me dorën e majtë...

NJË DHIMBJE MBAS VITESH

Po afronte mesdita dhe ishte qershor. Fletët e misrit fëshfërinin duke u fërkuar me njëra-tjetrën. Ishin fletë të gjelbëra dhe të freskëta të një misëroreje që edhe s'kishte zënë kallëpe.

Avniu, një burrë nja pesëdhjetë vjeç, ishte shtrirë në mes të një brazde, atje ku bimët ishin më të dendura dhe e mbronin nga dielli.

Ndjehej mirë ashtu, se toka ishte e punuar, e plehëruar dhe e vaditur me kohë, kështu që ishte e butë dhe nuk e vriste në shpinë. Avniu u kot një herë, pastaj bëri të ngrihej dhe të fillonte përsëri nga mbushja e misrit, por veshi i kapi ca zëra, që sa vinin qartësoheshin. Ishin shokët e brigadës së tij. Atij i zuri syri një djalë të vogël me flokë të shpupurisur, që rendte sa në një brazdë në tjetrën dhe thërriste sikur kushedi ç'të kish ndodhur:

— Ka ardhur agronomja!

Avniu ktheu kokën andej nga po rendte djali e, nëpër kërcenjtë e njomë të misrit, dalloi në mes të rrugës dy gra, që kishin vënë në mes një vajzë të panjohur të veshur me pantallona kafe dhe me një bluzë bojë qelli, që ecte duke biseduar kushedi se çfarë e duke qeshur herë-herë me gratë

që e shoqëronin. Ato u afruan te grumbulli i njerëzve me shata ndër duar, kurse Avniu e gjeti të udhës të kthehej nga krahu tjetër, gjithnjë nën hijen e gjetheve të misrit. Filloi të dëgjohej çafçafi i shatave, që përplaseshin e hynin në dherin e shkrifët, pastaj një zë vajze (sigurisht i asaj të porsaardhurës).

— Ja, kështu, xhaxho, mirë e ke, sa më shumë ta mbledhësh tokën kupale pas bimës, aq më shumë prodhon ajo... Pa shih, edhe toka e mban mirë vlagën.

Avniu mblodhi buzët për atë «çupëz», që i jep-te mend, e kujt pa... xha Tosunit, që një jetë të tërë misër kish prashitur e misër kish ngrënë! Ai u ngrit, mori shatën dhe koka e tij e bardhë doli përmbi fushën e gjelbër të misrit. Dhe pikërisht atëherë e vuri re vajzën e huaj, që sapo kishte ardhur. Ajo nuk ishte më shumë se njëzet e dy vjeç; qe afruar dhe po vështronte nga ai. Por Avniu nuk e kuptoi dot përse nuk e përballoi dot vështrimin e saj. «Përse më erdhi kështu? Nga që kam mbetur prapa shokëve në punë apo sytë e saj...».

— E shok-o, ç'thotë puna?

Ai s'mundi të përgjigjej, por u krua dhe filloi të qëronte barishtet, që kishin qarkuar kërcenjët e misrit. Fare papritur iu bë sikur diçka e rëndë e qëlloi mu në kokë. U ngrit, rrudhat e ballit iu mblodhën, goja iu hap dhe barishtet e egra nisën t'i bien nga duart që i dridheshin. Një afsh i nxehtë sikur i dogji qiellzën. Vështrimi i tij po sillej nëpër fytyrën vezake të vajzës, deri sa u përqëndrua te cepi i vetullës... te ai cep njihej një shenjë e vogël plage!

Ai s'mori vesh se çfarë iu përgjegj vajzës, nuk kuptoi se si iku ajo e si e la ai të ikte. Por kur shpatullat e saj humbën nëpër gjelbërimin e arës pranë, ai bëri të ecë, po u nxitua dhe bishti i shatës iu ngatërrua nëpër këmbë e kocka e noçkës iu godit sa i dhëmbi thellë.

U kthye prapsht, u sorollat si i shastisur nëpër arë, pastaj, duke rënkuar thellë, rrëmbeu shatën dhe u kërrus mbi brazdën. Punonte me një nxitim të ethshëm, punonte duke psherëtirë, punonte pa e pasur mendjen atje. Dhe që te mos e shqetësonin shokët, ai u nda prej tyre dhe mbushte misrin në drejtim të kundërt, andej nga ishin hijet e shelgjeve.

Filloi të errej dhe fshatarët me shata në krahë u nisën të ktheheshin. Disa syresh mbanin nën sqetull vandakë me bar të mbledhur arave, kurse Avniu s'po lëvizte nga vendi. Disa shokë e thërritën, por ai s'u përgjegj.

— Ore, si me shumë grysh e ka marrë ky sot!

— Si duket u turpërua nga agronomja e re!

— Më duket se ajo e thumboi, pse kishte mbetur prapa dhe, kur iku ajo ky u bë pikë e vrer!

Por këto Avniu as që i dëgjonte fare. Kuqëlimi i qiellit në perëndim u zhduk, retë u bënë të murme, pastaj filluan të nxihen, kurse Avniu, duke punuar si i tërbuar, qëlloi këmbën me shatë kushedi për të satën herë. Mbushte dhe rrallëherë e ngrinte pëllëmbën e tij dhe fshinte djersët, që i kullonin nëpër fytyrë.

Vonë natën e la punën, kur fshati flinte dhe dëgjoheshin të lehurat e qenve dhe shushurima e ujit të jazit, që shkante atje pranë. Shtyu ngada-

lë portën e shtëpisë dhe u fut brenda. E shoqja e ndjeu që erdhi, u ngrit dhe ndezi kandilen e vogël mbi oxhak.

— Po ç'u bëre, more burrë? Si sonte s'je vonuar ndonjëherë! Mos kishit mbledhjen e brigadës?

— Jo, jo... po ti bjerë e fli.

— Dale sa të të ve bukën.

— Nuk më hahet.

E shoqja mblodhi supet e habitur, u fut në rroba dhe priste që t'i thoshte ndonjë fjalë, por më kot. Ai kurrë s'kishte qënë ashtu. Zuri të kotej nën jastëk dhe pas pak u dëgjua frymëmarrja e saj e rregullt. Avniu kish mbështetur kokën te oxhaku dhe shihte thëngjijtë e ndezur në vatër, që dalngadalë po e humbisnin ngjyrën e bukur nën hirin e murmë. Ai s'dinte se çfarë të bënte, mori mashën dhe filloi të trazonte shpuzën dhe, sa më shumë e trazonte atë shpuzë, aq më shumë thëngjij të ndezur dilnin. Së fundi nuk u mbajt dot. Hodhi krahëve një gunë të vjetër dhe doli jashtë. Nata ishte e bukur, me yje; hëna e kishte larë fshatin rreth e qark me dritë.

Ai mori frymë thellë dhe, me duar të lidhura pas shpine, nisi të ecte pa ditur se për ku. Këmbët e çuan në breg të lumit, që gjarpëronte fshatit nën dritën e hënës; drita e kësaj sikur lozte me valët e vogla të ujit. Avniu u ul në breg të lumit. Ndjehej i shqetësuar dhe i vrarë.

Bëri të shkopsiste jakën e këmishës, por vrima ishte e vogël dhe ai e tërhoqi fort sa e këputi, pastaj fshiu djersët, që i kishin njomur zverkun. Për të lodhur jo... jo, nuk ishte i lodhur, por

diçka e mundonte, e brente dhe s'po e linte të qetë. Nxori kutinë e duhanit, por që ta dridhte cigaren nuk i përmbante dot duart; zemra i rrihte fort. Më në fund e ndezi... qëndroi ashtu, duke iu bërë shok qetësisë së natës përjashta, kurse, përbrenda, në mendime, shok lumit të rrëmbyer.

Po kujtonte kohë të kaluara. Buza i dridhej dhe kafshonte cepin e mustaqeve mbi to. Hodhi sytë më tej, matanë lumit, pa tokat e fshatit, dhe diç të largme, iu duk se pa atje, në tokën e tij... Një plug, një fëmijë të vogël, që ra mbi atë plug dhe veten e tij që u përkul mbi fëmijën të cilin e mori dhe i fshiu gjakun, që i rridhte nëpër fytyrën e njomë.

Tashti i bëhej se dëgjonte të qarat e fëmijës së vogël, se po ja fshinte lotët dhe gjakun, se po ja pllakoste me duhan cepin e vetullës. «S'ka gjë, s'ka gjë, kështu rriten çupat» i kish thënë atëhere çupës dhe s'kish ditur ç'ti bënte më shumë. Atëhere s'dinte se çfarë t'i bënte, por tani ato të qara të largme e shkundën, e bënë të kthehej vite më parë:

Ishte viti 1948.

Avniu jetonte në fshat me gruan e tij të re. Kishte një vajzë të vogël me sy bojë qielli e me flokë në ngjyrë të misrit. Vonë, natën, kur mungonte e shoqja, ai luante me të e ajo gajaste pas tij, i kapte mustaqet, ja tërhiquhte edhe qeshtë... këto sepse e shoqja mungonte shpesh. Kjo shkonte në qytet, në fshatra të tjera. Avniut edhe i vinte edhe s'i vinte mirë për të shogën. Nganjëherë e ndjente veten të gëzuar dhe përmbi shokët kur

e shoqja i fliste gjithë fshatit. Por ca nga ca, sikur zuri të mërzhitej.

— Nefo, ti tani u bëre me fëmijë, s'të kanë lezet mbledhjet, pastaj natën... ku është parë kjo?

Ajo e shihte me frikë, sepse ai mund edhe ta ndalonte, ashtu siç ndodhte edhe me ndonjë tjetër, mundahej t'i buzëqeshte Avniut e bënte sikur nuk u jepte rëndësi fjalëve të tij.

— Dëgjo, Avni, Partia ka nevojë për mua, për ty, dhe unë kryej porosinë e partisë.

Por ai s'deshi ta dëgjonte.

— Kështu si të them unë. Andej — këtej mjaft rende. Gruaja është grua dhe e ka vendin në shtëpi. Unë nuk kam nge të dëgjoj tevatyrë, nuk e ushqej unë gruan që të tjerët të bëjnë muhabet me të...

Dhe ditë e përditë Avniu nisi t'i kërcënohej. Ajo kalonte net të tëra pa gjumë, lexonte libra, të cilat Avniu i shihte shtrembër, që nën jorgan.

— Mo, po ç'ke ndër mend të bëhesh ti me këto libra! Apo të t'i marr dhe të t'i djeg?

— Po, nga librat veç të mira dalin, o burrë...

— Po, po, ashtu vërtet, po pa më pyet mua? Ti vete natën e kontrollon djemtë kur vaditin... e di ti ç'domethënë kjo për një nuse të re?

— Këtu nuk ka asgjë të keqe. Unë s'jam ndonjë e humbur...

Avniu mori zjarr dhe shpërtheu.

— Ashtu, ti e humbur s'je, por mua po më vënë brirë! E di ti këtë?

Ajo psherëtiu thellë dhe u mundua ta marrë me të mirë, por ai, tërë inat, i ktheu shpinën dhe pështyu fort në zjarr.

Dhe një natë ndodhi diçka që pritej, por që ajo nuk e priste. Kishte kaluar mezi i natës. Ajo sapo mbaroi mbledhjen me shokët e partisë dhe u nis për në shtëpi, por derën e gjeti mbyllur. Trokiti në portë, në xham. Një shok që e shoqëronte i erdhi në ndihmë.

— E po hape, o Avni!

Avniu tashti mënd u tërbua dhe ishte gati t'i qëllonte që brenda xhamet e dritareve. Gruaja goditi më me forcë, trokiti gjatë e dera kërciti. Avniu doli i egërsuar.

Ajo e pa siluetën e tij dhe e mori me mend se ishte në kulm të zemërimit. Por nusja e re u shti si e shkujdesur dhe lidhi shaminë e bardhë, që i kishte shkarë mbi supe.

— Mos, Avni, mos se dëgjojnë bota — i tha dhe u fut brenda. — Por ai më s'përmbahej dot.

— Naaa! Tjetër herë lidhe me kohë shaminë që ta zgjidhin të tjerët, ikë, shporru, zhduku te jot ëmë... dhe atje bëj mbledhje natën; atje shko bëj kontroll ndër djemtë që vaditin.

Dhe e qëllonte me grushte. Vajza e vogël, e struktur diku në një kënd, u zgjua e lebetitur, ndërsa e ëma u sul si e marrë, rrëmbeu vajzën, Dritën ndër krahë e bëri të dilte jashtë. Por edhe duke ikur, Avniu e qëllonte, e shtynte. Pastaj Nefua ndjeu derën, që u mbyll pas krahëve të saj dhe e kuptoi se ajo derë ishte e mbyllur për gjithnjë.

Tashti Avniut puhiza e lehtë, që bënte të dri-dhej ujët e qetë të lumit, i kaloi nëpër fytyrë, dhe e drodhi edhe atë si ujët e lumit. Kjo e solli në vete; kaloi dorën mbi sy si për të larguar ato kujtime të hidhura, por përsëri e brente dyshimi..

«Të jetë ajo... Drita ime? Tamam shenja e plagës së plugut, sytë bojë qielli dhe flokët tash-ti jo aqë të verdhë, ashtu si i kishte e ëma dikur, kur e mora unë. Sa shumë i ngjante! Sa e bukur dhe e plotë është bërë, ngjet nga dajallarët, po përsëri diçka ka nga nëna ime, kur ishte nuse e re po... po... Po si ndodhi që erdhi pikërisht këtu? Mos vallë ma dërguan këtu ata të gjyqit? Po ndofta nuk është ajo! Ehu sa fëmijë vriten në vetull! Por jo, sa e pashë, u preva në vend, ndofta se gjaku im ndjeu gjakun e vet.

Po vallë të mos dijë gjë ajo se ka ardhur në fshatin e saj? Nuk besoj që Nefua ta ketë dërguar këtu, më shumë ka mundësi ta kenë dërguar ata të gjyqit, ata që më gjykuan atëhere dhe që s'më lanë gjë pa thënë. Nefua është martuar dhe me siguri as që i shkon ndër mendje tashti për mua, pastaj ajo është kaq larg... Kur shkuan kru-shqit ta merrnin, m'u kthyen pas tri ditësh...»

* * *

Të nesërmen Avniu shkoi në punë më herët se zakonisht dhe ja nisi punës menjëherë. Donte të humbiste brengën e vet në punë. Punonte aqë me vrull, sa shokët i la prapa dhe, si e kishte nisur, nuk dihej se ku do të dilte. Dhe në fjalë e muhabet as afrohej fare, rrinte i ngrysur, ai që ishte gjithnjë i qejfit dhe i muhabetit!

Ndaj të ngrysur i lajmëruan se në mbrëmje do të kishin mbledhje. Avniu u nis me shatën në krahë, por prapa shokëve. U fut prapa të tjerëve në sallën e madhe të vatrës së kulturës dhe zuri një vend andej nga fundi.

Do të flitej mbi fushatën e madhe të mbushjes së mirave, do të jepeshin përfundimet e punës, por Avniu as që e kishte mendjen atje. Me bisht të syrit përgjonte se kush do të ulej në fronat e kryesisë, por nuk dalloi asgjë që t'i tërhiqte vëmëndjen. Pas zërit të një burri (që as e vuri re se kush ishte), ndjeu zërin e një femre. Gjaku i lloçoçiti në gjoks dhe kafshoi buzën e poshtme. Po fliste ajo, Drita, agronomja e re... vajza e tij...

Zëri i saj i ngrohtë e përhumbi fare, pështeti kokën pas murit dhe dorën e majtë e shkoi pas ballit, që i digjte. Iu bë se i rënkonte zemra. Ai zë i kujtoi Nefon nuse të re, kur fliste nëpër mbledhjet e fshatit... tamam kështu si Drita. Dhe midis emrave të të dalluarve ajo zuri në gojë dhe emrin e tij, të Avniut!

Dy lot iu rrukullisën e i ranë mbi pëllëmbën që e kishte pështetur mbi gju. Dy rrathë të vegjël iu formuan mbi pluhurin e dorës. Ai kaloi dorën tjetër mbi të që t'i fshinte gjurmët e lotve, por formoi aty ca si brazda të zgjatura e s'mundi të bënte gjë veçse të shtonte akoma numrin e vijave. Se dora po i djersinte e pluhuri duhej larë. Por tani duhej larë e gjithë dora pa të fshiheshin ato vija.

Avniu s'mundi të dëgjonte më gjatë e, kur të tjerët e kishin humbur tragën pas përfundimeve të punës, ai u vodh e bëri përjashta. Ecte dhe psherëtinte, vinte dorën mbi zemër, që i rrihte fort, dhe i dukej sikur i dhimbte.

DUKE KAPËRXYER LUMIN

Kish ditë që binte shi me hope e, si i thonë asaj ane, shi behari. Herë ja fillonte shtruar e herë-herë rrëmbyeshëm e, kur ja fillonte rrëmbyeshëm, gërryente ç'gjente përpara e lumi fryhej e derdhej arave, sikur të donte t'i ngopte me ujin e tij të turbullt.

Xha Nuriu kishte hedhur kërrabën mbi supe, duart mbi kërrabë dhe kishte vënë përpara tufën e bagëtive. Kur pa retë që po dendësoheshin e po uleshin poshtë, shpejtoi hapat dhe vështroi nga barinjte, sikur donte të kërkonte mendimin e tyre.

— Do të kemi shi, or djem!

— Po, o xha Nuri, po shi behari është...

Barinjte përpara e xha Nuriu prapa, po mundoheshin të mblidhnin kopenë sa më shpejt në udhën e fshatit.

— Shpejt, mor djem, më shpejt... do të na mbushet lumi e s'kemi si ta kapërxejmë bagëtinë pastaj.

— Mirë, o xha Nuri, mirë e ke ti, po bagëti

janë. këto, ku dëgjojnë ashtu si thua ti; pastaj rruga është mbushur baltë e tëra dhe këto s'ecin dot shpejt. S'e sheh që është ngopur toka mirë? Se ka ditë që bie shi me gjyme.

Pikat e shiut filluan e po dendësoheshin. Xha Nuriu u mbështuall më mirë me gunën e tij, që e mbante krahëve dhe psherëtiu thellë. S'shihte asgjë e s'mendonte asgjë, veç tufën ta hidhnin sa më shpejt matanë lumit. Ecte shpejt, jo si plak, që i kishte kaluar të shtatëdhjetat, po si djalë i ri. Vërtet ashtu i dukej vetja, prandaj rrinte më shumë pas të rinjve e kurrë s'e gjeje në shtëpi. Pas bagëtive ishte merak e gjithmonë ngjitej stanit të kooperativës.

Një shqerrë e bardhë rrinte gjithmonë pas plakut. Ky mundahej ta largonte, por ajo i fërkohej pas rrobave të shajakta e ecte krahas tij. Po kalonin një qafë mali e u duk sikur dielli ishte fshehur enkas aty, se sa u dukën barinjtë me tufën, ai shkëlqeu i praruar dhe nga guna e xha Nuriut filloi të dilte një avull i lehtë, që binte erë bulmet.

Po tej nga mali, ca re të zeza po dendësoheshin e dukeshin gjithmonë sikur aviteshin... dukej se andej binte shi i rëndë.

Po i afroheshin lumit që ishte fryrë e dukej sikur gulçonte. Xha Nuriu u drodh. Ja kish frikën lumit.

— Po tani si do t'i kapërxejmë bagëtitë? — mendonte.

U afrua shpejt te barinjtë që diç bisedonin, po zërat e tyre as që dëgjoheshin nga zhuima e ujit dhe nga blegërima e bagëtive. Plakut i erdhi

inat që ata po humbisnin kohën duke biseduar. Por një bari i gjatë e flokëverdhë as që shikonte fare nga plaku, i kishte hipur gjaku në kokë dhe vetëm thërriste, i thërriste shokut të tij, sikur vërtet ai t'ja kishte fajin:

— Po s'të thashë unë, o Mete?... t'i kishim dalë që sipër lumit, do të kishim arritur më shpejt. Hë tashti... hidhu, hë de, hidhu, në je i zoti. Do të na mbyten, do të na mbyten bagëtia dhe pastaj të gjitha mbi kurrizin tonë... hë de, hyrë! Po s'të pyet ai, ujë është, të rrëmben me gjithë dele...

Xha Nuriu s'e përmbajti dot veten:

— Pse, ore, me llafe do të merremi tani? Shpejt, shpejt... ore, djem ini ju apo... pse, ore, kështu do t'i shpëtojme bagëtitë ne? Zbathuni dhe mos më rrinin si hunj, po futjuni lumit!

Dhe vetë i pari çau përmes. Bagëtitë do t'i hidhnin një e nga një, duke i çuar dorë më dorë matanë. Xha Nuriu ishte në mes të lumit, këmbët i lëshonin mornica nga ujët e ftohtë dhe i digjnin nga gurët e mprehtë të lumit. Padashur i zuri syri manarin e Dragoshes, mbesës së vogël. Manari ishte me bojë të kuqe dhe xha Nuriu e njohu sa e pa. Sesi i erdhi kur e pa ashtu në mes të lumit; e mori në krahë dhe pastaj e hodhi mbi qafë. E hodhi mbi qafë dhe bashkë me të filloi t'i kapërxente bagëtitë matanë lumit. Peshën e saj s'e ndjente, por tashti diçka i rëndonte më shumë se manari që mbante mbi qafë. Shikoi një herë nga barinjte dhe i theri diçka përbrenda, i erdhi sikur ata po bisedonin për të. E tek ngatërronte gishtërinjtë e trashë mbi leshin e butë të deleve, psherëtinte thellë e dukej se rënkonte, dukej

se i fliste dikujt... ndoshta manarit që kishte mbi qafë... se herë-herë shkonte pëllëmbën e lagur pas zverkut të saj, sikur të kërkonte ta përkëdhente. Ish përhumbur me një lëngë të madhe në shpirt. Në mes të lumit me manarin në qafë atij i dukej sikur e rrëmbente vala, po përsëri i ngulte këmbët në gurët e lumit dhe shtrëngonte manarin... manarin shtrëngonte, por te Selvia i rrihte mendja...

«Selvi, të kam ngarkesë nga yt atë...»

Buzët e plakut dridheshin dhe duart ngaqëra i ngatërroheshin pas bagëtive. Lumi sa vente fryhej e zhurmonte e xha Nuriut i dukej sikur gulçonte më tepër ai se sa lumi... S'dinte ç'bënte, fliste me zë të dredhur, pastaj për një çast e mbli-dhte veten, kujtohej që aty kishte të tjerë, që e dëgjonin dhe heshte, po përsëri dukej sikur harronte dhe zëri i tij i ngjante asaj dallgës, që përplasej me potere:

«Selvi, të kam ngarkesë nga yt atë, të kam nga Selvia, ti je edhe gjak nga gjaku im... Selvi... jam në udhëkryq, jam në mes të lumit... Selvi, më djeg këtu përbrenda...»

Valët e lumit turbulloheshin gjithnjë e këmbët e plakut nguleshin më thellë pas gurëve të mprehtë. Ai shikoi qiellin, pastaj ujin e turbullt... i turbullt që vërtet, po shpejt do të kullohej, se xha Nuriu pa retë të rralloheshin, megjithëse shiu vazhdonte të binte me zhurmë e që lart, rrëkezat e vogla zbrisnin tatëpjetë dhe bashkoheshin me ujin e lumit.

Vonë u kthyen në fshat. Manarin e kishte

akoma mbi qafë xha Nuriu e njëri nga barirjtë vuri buzën në gaz tek e pa ashtu.

— Xha Nuri, ktheu ti tani, se i futim ne bagëtitë në shtallë... — Plakut s'i erdhi mirë. Ai djali sikur donte ta largonte nga bagëtia, iu duk atij sikur ja tha enkas për ta lënduar, po veten s'e bëri e iu përgjegj me të butë, ndonëse me zemërim në shpirt;

— Jo, more bir, jo. Po ja që s'më fle karari, po s'e mbarova vetë këtë punë... po hajde, hajde, hape derën shpejt se u lagën keq bagëtitë...

Kur doli nga shtalla, kullonte ujë nga shiu dhe nga djersa. Fshiu mjekrën me një peshqir që e mbante pas qafe dhe u nis për në shtëpi. U nis po këmbët s'i bënë të shkante më tutje. Atë që kish dëgjuar atë ditë s'donte ta besonte, por ajo e kish dërmuar fare e ai s'po dinte ç't'ë bënte. U egërsua dhe hyri në shtëpi si i marrë, por, sa pa mbesën, që i doli përpara, s'guxoi të thoshte asgjë. U ul afër vatrës dhe u mundua të ndizte çibukun. Selvia kuptoi se plaku diçka kishte. Ai kurrë s'rrinte pa folur e sidomos me të.

— Babagjysh...

Plaku hoqi çibukun nga goja dhe filloi të koolitej me të madhe pa i hedhur sytë fare nga Selvia... Ajo u drodh; rrotullonte sytë e zez dhe ja ngulte plakut në ata të tijtë sikur donte t'i kuptonte mendimet. Por e ndjeu që punët nuk shkonin mirë, se plaku as çibukun s'e mbante dot në dorë... i ra në prehër dhe mbi pantallonat e shajakta iu derdh duhani i grirë me çark. Ai mundohej ta mblidhte, po s'mundej... Selvia u ul më gjunjë dhe filloi të shihte të gjyshin:

— Babagjysh... shiko, ke thëngjillin të ndezur mbi pantallona, do të digjesh... — dhe ja hoqi me dorën e saj e e hodhi në vatër. Ai kish filluar të nxihej, por, me ta hedhur në vatër, filloi dalëngadalë të skuqej e, tani, as plaku e as Selvia, që po e vështronin, s'po e dallonin dot, sepse ai mori ngjyrën e mëparshme dhe u bë njësh me të tjerët.

Xha Nuriu shkundte çibukun në gurin e vatrës pa e ngritur fare kokën e çdo trokitje e çibukut i therte në zemër Selvisë.

Doli me të shpejtë nga dhoma e s'dinte ku të vente. Mori ndërresa të tjera, për të gjyshin dhe me to në dorë po mendohej ç'të bënte. Më në fund hyri brenda, u ul pas të gjyshit duke e kapur pas supeve:

— Babagjysh, ti je bërë qull...

Ajo i lëshoi ndërresat në prehër e për një çast vështrimet e tyre u kryqëzuan. Selvia pa se plaku i dridheshin buzët, se ai kishte një vështrim të egërsuar... po ajo vuri re edhe se ai nuk mundi t'i qëndronte dot vështrimit të saj, se uli sytë dhe filloi të kollitej.

Selvia e kuptoi se ç'kishte plaku. — Shkakëtare ish ajo. — Dy lot iu rrukullisën dhe i shkanë mbi mollëzat e kuqe të faqeve. Iu afrua prapë të gjyshit:

— Babagjysh!

Zëri i saj sikur i lutej përmes lotve, sytë e saj sikur i kërkonin ndihmë dhe buzët e duart i dridheshin.

— Babagjysh!

Po ai s'e kthente kokën fare, e dinte se vësh-

trimi i saj, sytë e saj do ta zbutnin... dhe ja filloi përsëri «kollës» së tij.

Selvia doli nga dhoma e trembur se mos e shihte e ëma tek qante, por Nija flinte në kthinën tjetër.

Plakut i dukej se i buçisnin veshët nga dënesat e së mbesës. Xha Nuriun s'e merrte gjumi; u ngrit dhe ndezi prapë cibukun... shikonte fjollat e trasha të tymit. Në fillim ato ishin të trasha, të dendura e r Rathë-r Rathë, pastaj rralloheshin, ngriheshin përpjetë e mbetej veç një vijë e hollë që mezi dukej...

...Selvinë e donte si sytë. E kish rritur vetë që të vogël, por e donte edhe më shumë, se ajo i kujtonte diçka të largët, të dashur e njëkohësisht të hidhur...

E shihte Selvinë tek rritej e bukur si një lule dhe i kujtohej Selvia e tij, që i kish vdekur ja, në moshë kur do ta martonte...

Plakut iu mblodh një lëmsh në grykë e i digjte përbrenda... i gulçonte kraharori. Kish një plagë në zemër për Selvinë e tij. Ajo i kish vdekur e re... e ai qe bërë shkaktar. Sa herë shikonte Rexhepin i pikonte në zemër e kujtonte Selvinë e tij. Atëherë ai s'kish dashur t'ja jepte atij të bijën e Selvia ishte mbytur në pus; ishte mbytur në pus nga mizoria e Nuriut vetë...

Por pas shumë vjetësh lindi një mbesë e tij e Xha Nuriu kishte ngulur këmbë ta quanin Selvi... kështu kishte dashur... se i thoshte mendja, që, plaga e së bijës do t'i mbyllej. Por, sa rritej Selvia, gjithnjë e më shumë e turbullonin sytë e saj. Sa shumë po i ngjante ajo Selvisë...!

«Po sot ç'më dëgjuan veshët, sot? Mos vallë ka një zot që vjen të më rëndojë përsëri? Selvia na do të martohet në derë të Selfos!»

«Jo, jo, kjo s'duhet të ngjasë, le të marrë kë të dojë, veç atë jo. Në fund të fundit vetë le ta zgjedhë, por jo në atë derë. Ajo derë ka marrë gjak ndër ne, nga një dorë e asaj dere është vrarë vëllai i gjyshit tim. Ata që kanë derdhur gjakun tonë me plumb... s'duhet të marrin kurrsesi një vajzë nga gjaku im... jo!»

Plakut iu ngritën damarët në gushën e rreshkur dhe shtrëngonte pas çibukut gishtat, që i dridheshin. Ish zemërvrarë, po zemra s'i bënte ta shante e ta lëndonte Selvinë.

U ngrit vonë nga rrobat, kur të gjithë kishin shkuar në punë dhe Dragushja e vogël, e habitur se i gjyshi kish mbetur kaq prapa atë ditë, po hynte në dhomë duke kafshuar një copë bukë me djathë e duke përpjekur këmbkat e vogla pas dyshemesë. Iu afrua të gjyshit dhe zuri të lozte pas tij. Po ai as që ja vuri veshin e s'kish ndërmend të merrej me të. U ngrit rrëmbimthi dhe aqe nxituar, sa ja rrëzoi mbesës së vogël atë copë bukë, që e kafshonte me aqë shije, duke e lënë të habitur e të zemëruar e u nis për nga mali përpjetë, andej nga kishte shkuar kopeja.

Sa doli mbi Bode, në pllajën përkundrejt, pa një grumbull njerëzish që punonin e shkullnin shkurre e ferra.

«Pa të kaloj asaj ane...»

Krahët i kish hedhur mbi kërrabën prapa kurrizit dhe shkelte pa vështruar se ku.

«Ja, kësaj të Dolanit i thonë tokë... vendi shëndoshë e tokë e trashë!»

Por sa ngjitej më lart, vendi bëhej më i ashpër dhe gjelbërimi më i kursyer e si i shplarë. Xha Nuriu arriti te Qafa e malit me mundim të madh, se vendi ishte përpjetë dhe i zhveshur e aty-këtu kishte vetëm gurë. Po, sa arriti atje, shtangu në vend nga habia. Gjithë pamja që kish para syve iu duk e pabesueshme: Vendi që pastruar nga shkurret e ferrat dhe aty që hapur një tokë e re. Xha Nuriu u ul, mori një grusht dhe në dorë dhe filloi ta bluante me gishta në pëllëmbën e ashpër. I dukej sikur në atë grusht kish diçka të madhe, diçka që kish të bënte me jetën. Ish një grusht dhe i freskët, i kuqërrem dhe plot fejza rrënjësh. Sa vjet kish i mbuluar me atë cipën e murme! Kurrë nuk i shkonte ndër mend njeriut se aty brenda në thellësi të kish një tokë të tillë që do të mbillej e do të prodhonte. Plaku shtërgonte grushtin e mbledhur, e hapte përsëri e fliste sikur bisedonte me njeri:

«Si bukëvale është. T'i hedhësh edhe ca pleh mali, pleh fletësh e bëhet një vreshtë këtu që...»

Xha Nuriu i shihte ata që punonin e s'i shquante dot mirë. Shkoi më tej dhe, në një copë vend të papunuar, pa një palë shtiza, diku një palë sandale kauçuku, në një vend tjetër një libër e më poshtë, në një si gropë... një qindizmë... E njohu, ish qindizma e Selvisë. Diku xha Nuriut i zuri syri Danen, që kishte vënë duart në bel e diç u thosh-te të rinjve.

«As ngrihem e shkoj në punën time!... po më vunë re që jam këtu, me siguri do të nisin të shpojne e të rëmojnë...»

Nga të rinjtë plasi një e qeshur e fortë; dikush bërtiti:

— Çou!

Dhe djem e vajza kërcyen përpjetë, rrëmbyen veglat e punës kur papritur e pakujtuar dikush zuri në gojë emrin e tij:

— Kur ta shpiem dritën në fshat, llambën e parë t'ja ndezim xha Nuriut, se ai s'beson... po një llambë të madhe, ama, ja... kaq!

Dhe ky që fliste kështu, ishte djali i Selfos, ishte ai që qeshte e buçiste me të madhe e ndofta e bënte këtë që Selvia ta dëgjonte e ta vinte re...

* * *

Kaluan ditë e pas shirave, filloi thatësira. Misi kish hedhur shtat, por kish nevojë të vaditej. Xha Nuriut iu lutën ata të kryesisë që të linte kopenë dy-tri ditë dhe të merrej fushës me brigadën e arave.

Plaku u ngrit herët, që pa gdhirë, mori shatën në sup, ktheu ujërat te Vau i Mëash dhe u nis pas rrjedhës. Ecte krah kanalit e thithte çibukun; hidhte sytë në kanal, por nuk dallonte dot atje brenda... nuk shquante dot valëzimin e ujërave... hera-herës i dukej sikur dëgjonte zhurmën e ujërave e i bëhej se kalonte përkrah rrjedhës, por më tutje e kuptoi se kishte qenë fare ndryshe: ujërat kishin ikur përpara e ai në të kundërtën.

Te parcela e madhe hoqi opingat, ngriti pantallonat e shajakta dhe i llapashiti këmbët në ujin e ftohtë. Akoma s'kish lindur dielli dhe ai e ndje-

nte të ftohtit e ujit, por ca nga ca këmbët iu më-
suan. Dhe, tek merrej me ujërat, mendonte për
Selvinë, për grindjen që kishin pasur në shtëpi.
Kishte folur rëndë, aqë rëndë, sa tani i vinte
turp...

«Kur të vdes unë do të vesh ti në derën e
Selfove. Po të mbushet koka ty, moj, se ata na
kanë vrarë?»

«E di, e di, por dy breza kanë kaluar...»

«Mbylle të thashë. Se mbylli sytë e shkoi yt
atë, pa më flet kështu; të ishte ai pa ta këpuste
kokën.

«Babagjysh, punë të shkuara, të harruara.
Pastaj ai s'kish lindur atëhere... as unë...»

Dera e kthinës ish hapur dhe kish hyrë Nija,
duke ndrequr shaminë e kokës:

«Ç'bëni kështu në mes të natës! Dale ago
Nure...»

Dhe ago Nuriu, nga biseda me nusen e të bi-
rit, e kish kuptuar se edhe kjo ishte bërë njësh
me të bijën. I egërsuar dhe gjithë inat ishte sulur
të dilte përjashta, por të dyja ato e kishin kapur
pas duarsh, pas supesh dhe e lutnin, e shtrëngo-
nin, ngulnin këmbë të mos ikte. Ai u kish shpë-
tuar nga duart, kishte marrë shkallët tatëpjetë,
por aqë nxituar, sa balli i qe përpjekur pas par-
vazit të shkallës. Koka i kishte therur fort, pastaj
shkallët sikur i erdhën rrotull dhe gjunjët iu
prenë...

«Babagjysh, të keqen, e zeza unë...»

Në ballin e xha Nuriut ishte ngritur një xhu-
ngë sa një kokërr arre, që filloi t'i nxihej.

«Gërvishte vendin, ago Nure... gërvishte që

të të dalë gjaku i lig. Të keqen ago Nure, mos e lërë gjakun e lig të të mblidhet...»

Plaku qe përgjunjur në krye të shkallëve, pastaj qe ulur shesh aty dhe s'dinte se çfarë i dhëmbte më shumë, xhunga në ballë, apo zemra në gjoks.

... Përfund parcelës rrodhën ujërat e ranë poshtë në rrugën me kalldrëm. Xha Nuriu fshiu djersët e ballit me shpinën e dorës. «... Duhet kaluar në parcelën tjetër» — mendoi.

Zbriti në rrugë, ngriti shatën dhe i futi ujërat në kanal in e dytë. Deshi të lante duart që të mbushte çibukun, por ujërat qenë të turbullta e bëri tatëpjetë te burimi. Aty i lau duart mirë e mirë, u shtri përmbys, piu ujë, pastaj mbushi çibukun...

«Kur zihen dy njerëz, pasi kalojnë disa muaj a s'kanë dëshirë të pajtohen?... po kur vriten? Jo, jo se nuk është njëlloj... po kështu na e paska jeta. Brezat që vijnë...»

Plakut iu drodhën gjunjët. Kishin kaluar vite që atëhere, kur etjen e shpagimit e kish të fortë... po megjithatë zemra s'i bënte të falte...

«Jo, jo... unë e kam të vështirë... për mua është e rëndë kjo, po brezat që vijnë... s'do të kujtojnë asgjë...»

Xha Nuriu dëgjoji njerëz poshtë nga arat që këndonin.

Këmbëzbathur arriti te gardhi e, meqë s'dinte ç'të bënte, shkuli një purtekë të gjatë e me të në dorë rrihte ujin e Vaut.

Prapa krahëve dëgjoji ca çuçurima të lehta,

ishin shoqet e Selvisë. Ato me shata ndër krahë shkonin tatëpjetë.

Plakut i theri përbrenda, u bë gati të pyeste për diçka, por u përmbajt. Mendoi i tmerruar: «Mos...?» po zemra s'i bënte të thosh asgjë.

Njëra nga vajzat u kthye shpejt nga ai, e përshëndeti dhe fytyrëqeshur i foli:

— Selvinë e takuam rrugës, xha Nuri. Po vjen me të tjerët... sot do të punojmë për dritat!

E HUMBA NJË SHOQE...

— Leti... — thirri aq fort, sa kalimtarët kthyen kokën të shqetësuar, por ajo as që e vuri re këtë; u sul drejt shoqes dhe ish gati t'i hidhej në qafë, ta përqafonte, ta puthte fort; aq shumë e kish marrë malli për të.

— Leti... — po krahët i mbetën pezull e iu rrezuan poshtë pa forcë. Drejt saj u kthye një vajzë e veshur bukur, me këpucë të larta dhe me një çantë dore mjaft elegante... por me një buzëqeshje të shtirur në fytyrë.

— Ah! — klithi Liza, po klithma i mbeti në grykë, buzët e shtrënguara s'e lanë të shpërthente — Ti? — gati sa nuk iu besonte syve dhe s'e pat mbledhur akoma veten, kur dëgjoji një murmuritje fjalësh:

— Ah, paske ardhur! Gëzohem. Si je me shëndet?

Ajo fliste ngaççinë, sikur t'i numëronte fjalët. Liza mbeti si e hutuar: herë vështronte çantën e Letit, flokët, fustanin, këpucët... pastaj shtrëngoi fort çantën e vet, librat, leksionet e veta e

tu duk sikur gjeti aty shtrëngimin e qindra duarve... duar malësorësh që e prisnin. «Leti të jetë kjo?» — mendonte. Deshi t'i fliste, ta pyeste për diçka, por e trondiste thellë ai vështrim i akullt.

Kujtoi si nëpër mjegull kohën që kishin kaluar bashkë... dukej sikur atyre kujtimeve u kish rënë një dantellë e përhime e po zhdukeshin dalëngadalë e, tej në sfond, shquante një si njo llë të zezë...

2

Salla e leksioneve ishte mbushur plot me studentë. Përveç atyre të vitit të fundit, ishin pothuaj edhe të gjithë studentët e vjetve të parë. Jashtë bënte ftohtë, por aty brenda duhej të hiqje edhe xhaketën. Pas atij që fliste, ndihej menjëherë një rrapëllimë e fortë duartrokitjesh.

Leti ishte ngritur më këmbë dhe me zërin që i dridhej nga emocioni, i dha fund fjalës së saj: «Nën shembullin e Ismetit, ne edukonjësit e brezit të ri, si ai, do të shkojmë ku të na kërkojë atdheu.»

U ngrit pas saj Liza dhe foli qetë e me zë të vendosur: «Lista jonë u bë aq e gjatë, sa është e kotë të shënohen emrat. Mendoj të shkruani vetëm qind për qind gati, nën shembullin e Ismetit.»

Zëri i saj kumbonjës humbi nëpër atë breshëri të fortë duartrokitjesh. Mbledhja kish mbaruar. Të fundit po dilnin nga salla me zhurmë.

Ai emocion, ai vrull rinor dukej sikur pat mbirë në zemrat e tyre e pat shpërthyer me aq forcë, sa s'qe parë ndonjëherë.

Sokoli bisedonte me shokët; padashur i zuri syri Letin dhe Lizën, që dualën të fundit nga salla e mbledhjes. Ai iku pa u vënë re dhe hyri në mes të shoqeve.

— Hë?... ama mbledhje! S'ma merrte mendja të qe kaq e zjarrtë. Kujtoja se midis nesh do të kish edhe ndonjë të «borgjezuar», që do të strukej pas shpinës së ndonjë shoku.

— Oj, filozofi! Pse, ç'kujtoke ti? A mos neve s'na pëlqen malësia? Liza fliste shkujdesur, me shaka, duke vërtitur nëpër duar një kopsë të xhakëtës që i varej e ish gati t'i këputej.

— Gjynah, të kishim lënë vetëm Sokolin të fliste! Ne të tjerët dualëm si të tepërt. Meqë e mori fjalën i pari, le të mbetej ai «heroi».

Sokoli u kthye nga Leti shpejt, gati i zemëruar e dukej sikur do të hakmerrej në çast për këtë «fyerje». Kapërdui pështymën me zor, heshti një çast, pastaj kapi vjedhur vështrimin e Letit, kur po i shkelte syrin Lizës.

— Më falni, nuk e kisha fjalën për ju!

— Mos u piperos kaq, de, bëmë shaka!

Që të tre qeshën fort. U ishin afruar shkallëve të konviktit:

— E po natën e mirë, vajza!

Ai i shtrëngoi dorën Lizës, pastaj Letit e, kur i shtrëngoi dorën kësaj ja mbajti gjatë në pëllëmbën e tij dhe e vështroi thellë në sytë e saj të bukur. Leti buzëqeshi pa të keq; i futi kra-hun Lizës dhe hynë në dhomën e tyre.

— Leti, si të duket ky... Sokoli?

— Djalë i mirë!

— Po ti ke vënë re gjë?

Ajo ngriti supet, e vështroi Lizën dhe tundi pak kokën:

— Jo.

— Jo?... Gënjen!

— ...!

— Leti... ai... më duket se të do...

— Pastaj?

Liza s'dinte ç'ti thoshte. Leti s'po ja zgjatte fare bisedën dhe ajo e ndjeu veten keq:

— Pastaj? Çfarë pastaj...?

— Liza, e lëmë këtë bisedë?

— Si të duash, po unë...

— Mirë, mirë, e bisedojmë njëherë tjetër.

Tani flemë se vajti vonë... — Ato të dyja s'i zinte gjumi. E dinin se as njëra e as tjetra nuk flinte. Liza ish kthyer në kurriz dhe kish ngulur vështrimin diku, në abazhurin e vogël të dhomës.

Leti, me duart rreth qafës, nuk kish rehat. Mbante frymën sikur të përgjonte diçka, priste se mos Liza e thyente atë heshtje. Ajo mbylli sytë, mbuloi fytyrën me pëllëmbë dhe psherëtiu lehtë, aq lehtë sa mezi dëgjohej.

— Leti, të zuri gjumi? — pyeti Liza.

— Jo!

— As mua...

Ato heshtën një çast.

— Liza, po deshe, hajde këtu te krevati im.

U pa puna, s'kemi gjumë sonte.

Liza u ngrit shpejt, zbriti nga krevati i saj dhe hyri në krevatin e Letit. Gjithë natën çuquritën

me njëra-tjetrën. Ashtu të dyja e ndjenin veten më mirë.

— Liza, po sikur të na ndajnë?

— Budallaqe, e kush na ndan ne! Në fund të fundit, do të kërkojmë të na çojnë në një vend më të largët, vetëm të mos na ndajnë...

— Në një vend më të largët...po...

Liza ngriti pak kokën për të dëgjuar më mirë:

— Hë...

— Jo, jo, Liza, asgjë... nuk thashë asgjë.

— Mos ki merak... e di unë... edhe Sokolin me ne do ta caktojnë...

Leti qeshi me vete. (Sa mirë që ish errësirë, se Liza do ta kish parë sa fort i shkëlqyen sytë!) Zjarr i mori fytyra dhe foli shpejt për të mposhtur turbullimin:

— E ligë, e ligë!

Heshtën përsëri. Donin të vështronin në errësirë sytë e njëra-tjetrës, po nuk shquanin dot asgjë...

Që kur u njohën, u deshën fort. U dukej sikur ishin rritur, kishin jetuar bashkë dhe s'mund të rrinin asnjë çast pa njëra-tjetrën.

Në institut i quanin «Motrat». Fustanet, këpucët, çdo gjë e kishin njëlloj, trupin njëlloj... vetëm flokët i kishin Liza të verdhë e Leti të zez pisë e kaçurrel, dhe i binin gjithmonë mbi sy. Shpesh inatosej me ta e i priste vend e pa vend po, për çudi, ngaqë i kish shumë të dendur, nuk i shëmtoheshin fare, gjithmonë i kish të bukur.

Liza e donte shumë, më shumë se ç'e donte Leti, a ndoshta edhe Leti e donte, por s'e shfaqte dot; ish natyra e saj e tillë. Liza ish mësuar me

të, si ajo vajza e vogël që nuk rri dot pa kukullën e saj edhe në gjumë...

Çudi! Sa e fortë është dashuria e vajzave! E kur ato e duan shumë njëra-tjetrën, padashur midis tyre lind xhelozia. Çfarë xhelozie? Për gjëra të kota... në qoftë se Leti do të bisedonte me ndonjë shoqe tjetër më shumë se me të, atëhere Lizës do t'i vinte keq, do t'i dukej sikur ajo po largohej prej saj, sikur nuk e donte më.

3

Mbaroi edhe praktika mësimore.

Liza ish kthyer në konvikt më parë se Leti. Nuk po i rrihej pa të. Ishte hera e parë që i ndanin: Leti kish shkuar në vendlindjen e saj, kurse Liza në një rreth tjetër. Liza shtynte orët deri sa të vinte mbrëmja e të dilte ta priste te autobusi...

Nga lindja dielli qëndronte pezull në qiell e dukej sikur lëvizte ngadalë. Kuqëlimi i tij u jepte një shëndritje vezullonjëse trotuareve, rrugëve e kopshteve përreth, të cilët sapo ishin larë nga shiu. Lule shpatat pikonin vesë, që shkiste nëpër cipën e lëmuar të fletëve të tyre të mëdha. Tek-tuk bari kish filluar të gjallërohej e natyra sikur kish marrë një pamje tjetër. Dukej sikur po zhvishej nga ndryshku i dimrit e po përtërihej papritur.

Liza ecte ngadalë nëpër kopshtin e vogël me pemë, para konviktit (të gjithë studentët e quanin atë «Kopshti ynë»)

Sokoli me shokët po krasitnin pemët përreth. Liza qeshi dhe i erdhi mirë. Ç'djem — mendoi.

— S'rrinë një minutë pa punë. Me të tillë mësonjë do të ecim përpara!» Kaloi ngadalë pranë tyre si pa u vënë re; Dëgjoi Sokolin, që i thosh Shpëtimit:

— Shpëtim, po ti hyrë brenda, je i sëmurë... pastaj se mos kemi për të bërë ndonjë gjë të madhe; nuk kemi as gërshërë...

Sokoli e përdorte me lehtësi gërshërën dhe vështronte me bisht të syrit Bashkimin. Ky, e përdorte me zor veglën, po punën s'e linte.

— Ore, po si nuk morëm edhe ndonjë nga të vitit të parë; ta mësojmë për not. Mot kur të lidhin kokrra këto kajsitë do të na kujtojnë edhe ne. E... mbolla unë të hanë të tjerët, kështu e ka kjo punë, e? Mirë e kam? — qeshte Bashkimi.

Sokoli ktheu kokën papritur dhe vështroi Lizën, që qëndronte aty, më këmbë, me jakën e pardësytë të ngritur. Faqet i ishin skuqur nga era e ftohtë dhe në buzë e sy sikur i kish ngrirë një buzëqeshje.

— Ah, Liza... paske ardhur? Po... qenke vetëm...

Liza e kuptoi ku donte të dilte Sokoli, e mori me mend se ai priste si edhe ajo:

— Mos ki merak, në mbrëmje s'do të jem më vetëm...

— E, shejtane..!

4

Liza vështronte e habitur Letin. Nuk ish më ajo Leti e parë, nuk e kish më atë shkëlqimin e dikurshëm të syve; se si vështronte ftohtë, e sikur nënqeshte me djallëzi.

Flokët i kish ndryshuar... dukej më mirë; e kish ndryshuar (kështu iu duk Lizës)... nuk ish më ajo Leti e shkujdesur, me ata flokë të bukur e të çrregullt, tani i kish kapur mbrapa kokës me një karficë me gurë të ndritshëm.

Lizës sesi i erdhi! Deshi të qeshte me të madhe, por vështrimi i Letit e shqetësoi.

— Leti, po si kështu? Ç'është gjithë ky ndryshim?

Leti u kthye nga Liza, nënqeshi pak dhe belbëzoi ngadalë:

— Liza... e di? U fejova...

— Si!? U fejove? Kaq shpejt? Po ku e njohe ti atë?

Liza s'dinte ç'liste, nuk dinte ç'kish, i merrej goja, s'ish e zonja ta mblidhte veten, ndërsa Leti foli qetë:

— Unë... e njoha pra, tashti...

— Si? Nuk e njihje dhe e njohe për tri javë? Leti ngriti supet, s'dinte ç'ti thoshte, ndërsa Liza buzëqeshi hidhur dhe mendoi me vete: «Edhe për dy muaj do të mbarojmë studimet, do të na vijë emërimi dhe...»

— Leti... e zuri për duarsh dhe e afroi pas vetes; e pa thellë në sy:

— Po ku punon ai, ku jeton?

— Në Tiranë...

Liza e përfytyronte Letin midis njerëzve, faqerësisht të saj: tezes, hallës, kushërinjë e tetos, që i flisnin: «Ç'të duhet ty! Lëri ç'thonë gazetat, siguro jetën, Tiranën, do të rrosh në palcën e vendit. Djali si flori... ç'do ti... apo të marrësh ndonjë «malësor»...

Ç'na dëgjojnë veshët! Vete e bija e botës nga qyteti dhe martohet në fshat!»

Liza e kish vënë re këtë ambient, kur kish vajtur njëherë në shtëpinë e Letit; aty gjithshka i ish dukur e zyrtë, por Letit s'i kish thënë asgjë. Kujtonte se mos edhe Leti e ndjente këtë...

Liza ndjeu neveri, për të parën herë iu duk Leti e shëmtuar me ata sy të akullt:

— Ti e do «atë»?

Ajo mblodhi supet dhe ngriti sytë, e trembur.

Liza e dinte... sytë e saj sikur donin t'i thoshin:

«Budallaqe që bëhesh! Unë do të jetoj në mes të Tiranës kurse ti shqetësohesh... kur kujtoj ato «malësitë» e tua, më ngjethen mishrat. Shko ti andej... e ç'më duhet mua të zë rrënjë maleve si ju të tjerat»? Liza nuk e kish ndjerë veten kurrë kaq keq. Letin nuk e shikonte dot në sy, i vinte turp...

Heshtnin të dyja. Pastaj Leti foli:

— Leti...unë e di... ti nuk e do «atë»... po ti e bëre këtë se ke...frikë nga puna, ke qejf të zësh një qoshe të rehatshme e të mos cash kokën për asgjë. Po pse qesh? Pse më vështron ashtu? Ke të drejtë, ke zgjidhur problemin më të vështirë në jetë. Punë e madhe që s'e do! Në fund të fundit do të sigurosh qytetin... s'i thonë shaka... në mes të Tiranës... Si ti ka edhe të tjera, që mendojnë për një burrë me pozitë në Tiranë, që, akoma pa dalë mirë në jetë, rendin poshtë e përpjetë, nxitojnë për të gjetur një «burrë», mjafton që t'i shpëtojë nga fshati... po ato janë pak...

Leti papritur i zgjati dorën dhe pastaj u lar-

gua midis turmës së njerëzve, përgjatë trotuarit, i cili po lagej nga shiu, që filloi të binte, në fillim i imët e pastaj i rrëmbyer e me zhaurimë.

Liza u mbështet te një trung peme; sytë i digjnin nga lotët që i mbante me zor. Mbeti ashtu në mes të rrugës. Shiu i lagu zverkun dhe ajo u drodh lehtë. Megjithëse ishte lagur, siluetën e Letit e dallonte midis asaj turme të madhe. Nuk deshi t'i ngatërronte ata me Letin, nuk deshi që në atë turmë të kish ndonjë «Leti», por ajo ecte midis tyre, ndonëse... vetëm.

Vazhdonte të binte shi. Lehet e luleve anës së trotuareve posa ishin punuar dhe bari anës tyre dukej më i ri e më i bukur.

Liza shtrëngoi çantën nën sqetull, u pengua në ca degë të hedhura pa kujdes. Iu kujtua Sokoli, degët e thara të pemëve, që kish krasitur ai.

Ndërroi rrugën, nuk deshi të ecte andej nga kish shkuar Leti, nuk deshi të shkonte pas gjurmave të saj. E ndjeu veten më mirë tani, megjithëse me një zbrazësi të madhe në zemër: kish humbur një shoqe. ,

VAJZAT QË SHËRONIN PLAGË

Ja kushtoj nënës sime.

I shte e re, akoma s'i kish mbushur të gjashtëmbëdhjetat, po kish një trup të bëshëm, dy sy ngjyrë ulliri të mbyllur, flokë të butë e të gjatë ngjyrë gështenjë. Kish një fytyrë të bukur, pakëz të hequr e një lëkurë të butë e të bardhë që herë-herë merrte ngjyrën e trëndafiltë e atëhere ti-paret e saj dukeshin krejt fëmimore.

Tarikua ishte e re nga mosha; e re ishte dhe linja e bardhë që mbante në kokë. Me të ajo kishte shtrënguar flokët dhe dy cepat e saj i kish lidhur nën gushë. Po ajo punonte me nxitim sikur e ndiqnin, sa flokët e saj se ku gjenin shteg e se ku gjenin rrugë e i derdeshin qafës e faqeve, gushës e gjer supeve.

Ajo ishte ulur në gjunjë me trupin të përku-lur përpara. Nën sqetull shtrëngonte dy bigat e mashës, ndërmjet të cilave kish vendosur fletë të thata duhani, ndërsa dorezën e saj e kish mbështetur për tokë. Me dorën e djathtë, me një si kosore të vogël, e grinte duhanin me shpejtësi.

Mbi një shami të bardhë derdhej duhan i grirë. Ajo shpesh shkonte dorën mbi të, e hapte

me gishta, mbushte grushtin, e afronte për ta parë dhe përsëri e derdhte mbi shami.

Herë-herë i dukej se gjumi ja rëndonte qepallat që ajo përpëlितte lehtë, pastaj trazonte me një urë të vogël shpuzën e zjarrit, ku ziente një poçe me fasule. Anës së vatrës ishin varur rroba të lagura (ishin një palë rroba shajaku, xhaketë e pantallona e një palë çorape të trasha të punuara me lesh dhie).

Sa shumë duhan duhej të grinte! Sa shumë duhej të lodhej! Po ajo nuk lodhej. Iu skuqën faqet dhe një turbullim i ëmbël i kaloi në gjithë trupin. Gjithnjë ja lëvdonin duhanin. Ajo e mban-te mend mirë kur një partizan i pat thënë: «Duh-an i mirë, për besë, i grirë si në havan, i shkri-fur dhe i butë si kadaif!» Një tjetër, një djalë i ri me një palë mustaqe të holla, duke dredhur një cigare, kish vënë buzën në gaz e kish thënë: «Ah, po e kam thënë unë... nga duart e kësaj vajze s'del gjë e keqe...»

Tarikua e kish vështruar drejt në sy, por jo për fjalët se sa për mënyrën se si ishin thënë ato fjalë...

Te vatra, ku punonte Tarikua, gërhinte gjyshi me një fëmijë në prehër, në odën tjetër flinin dy motrat e saj, e ëma dhe gjyshja, kurse vetëm ajo ishte zgjuar dhe grinte duhan... Tani, nga flakët e zjarrit në vatër, fytyra i kish marrë një ngjyrë të kuqe të ndezur e hija e trupit të saj pasqyrohej përballë në mur, duke formuar aty një figurë të çuditshme, që gjithnjë lëvizte, gjithnjë ulej e ngrihej.

Ishte shtënë aq shumë pas punës, sa bigat e mashës nisën të nxeheshin nga fërkimi me te-

hun e thikës së çeliktë. Nga balli i dilnin bulëza djerse e ajo ndjeu se edhe flokët e butë i kishin marrë erën e duhanit. Vajza e la duhanin dhe ktheu rrobat e lagura prej shajaku që thaheshin pas zjarrit. Hapi një kanat dërrase të dritares, që kërcëlliti dhe që andej pa se po zbardhte. Një kanistër me linja të lara e mori nën sjetull dhe doli jashtë që t'i ndërte. Tarikos iu duk sikur ai agim i bukur prandvere e çlodhi, e mbushi me jetë. Lëshoi kanistrën përdhe e nisi të ndërte rrobat një nga një. Përmes telave e litarëve ajo vështrroi brezat me bloqe guri të Lozhanit, koriet me arra e pemë. Atij mëngjezi gjethet e kumbullave e të thanave ndrësinin nga vesa e shkëlqyer. Ajo shkonte përgjatë telit të tendosur deri te mani i bardhë. Që lart prej fletëve të tij filluan t'i binin pikëza të vogla vese; një syresh i pikoi në kokë, i kulloi nëpër qafë e gjer nën gushë. Ajo u drodh e ndjeu në trup lagështinë e mëngjezit. Ish-te herët, por fshati filloi të zgjohej, kecat e njomë blegërinin nëpër hajate, njerëzia të përgjumur ngriheshin e nisnin punën. Edhe fëmijët kishin detyrat e tyre.

— Agim, u ngrit nëna?

— Hë, hë — foli i vëllai i shtrirë në kurriz, duke fërkuar sytë e përgjumur.

— Foli Safijes të vijë, o xhan, foli që të nderzim furrën!

— U ngrit, moj, u ngrit; po fshin odën lart.

— E po atëhere merri kecat, t'u bëftë motra dhe ec lart nga koria, po mos shko thellë se s'dihet... merr edhe Dritën dhe lëre atje me kecat. Dëgjon? Dhe vetë më sill ca degë dushku për

furrën, hë xhan i motrës! Sa t'i vë flakën unë, ti vjen.

I vëllai mori torbën në shpinë, kecat përpara dhe u nis.

— Me se më ke vënë bukë?

— Misërnike me gjizë... dhe një qepë të bardhë... Drita! Hë, të keqen, nisu me Gimin.

Ajo shpupuriti lehtë flokët e së motrës; i rregulloi jakën e asaj që e quanin dolloma dhe e nisi pas të vëllait. I përcolli larg me njëmijë këshilla:

— Gimi, mos harro ç'të thashë!

— Jo, moj, jo!

— Hë xhan!

— Unë s'kam frikë as nga pushkët — tha

Drita.

— Ç'frikë të kesh, s'ka gjermanë këtej, po hajde se na zuri vapa.

Ai fliste si i madh dhe Tarikua qeshi nën buzë. E shikoi me dhëmbshuri dhe i dha zemër së motrës:

— Po ti pse ke frikë, ke Gimin, ku të lë ai ty..?

Ajo i ndiqte me sy tek iknin ata të dy të vegjël, kërthinj. Iknin duke mbajtur edhe ata hallet e luftës në kohën kur duhej vetëm të loznin e të mos mendonin për asgjë. Nga larg vinin zhurmat e luftës dhe jehona e grykave shkëmbore të Moglicës i rrëmbente ato krizma dhe i shëtiste nëpër pllaja e nëpër maja. Andej djemtë luftonin.

Që lart nga qielli erdhi një ushtimë e fortë, pastaj një gërvimë e çjerrë... po kalonte një aeroplan, që dukej sikur po lëkundej.

— Safije, lëre fshesën dhe eja të ndezim furrën; jemi vonë. Në drekë do të vijnë partizanët për bukët.

Tarikua psherëtiu me sytë nga qielli: «Vallë ku mitralon ky i mallëkuar?»

— Erdha — u ndje zëri i hollë i së motrës. Ato të dyja morën drutë në krahë. Ishin dru të rënda prej lisi. Ashtu e ndezën furrën e vogël të lyer përsipër me baltë të verdhë. Tashti krizmat s'ndiheshin më, veç uturima e aeroplanit dëgjohej thellë nga grykat e Moglicës.

Të dy vajzat ja morën lehtë një kënge që sapo kishte dalë:

Dalngadal' po vjen behari,
Dalngadal' po na vjen,
Nëpër fusha rritet bari,
Dalngadal' po na vjen...

— Tariko, pa dëgjo...

— Çfarë?

— Ca zëra...

— Ja ku dolën dy partizanë; po vijnë për bukët.

Nën rrezet e diellit xixëlluan kollanët e partizanëve të mbushur me krehër fishekësh. Ishin një djalë e një vajzë. Motrat ikën nga furra dhe të dyja u sulën atje ku qëndruan ata, por në atë çast grykat gjëmuan fort, jehona ushtoi mal më mal. Aeroplani ishte ulur shumë poshtë.

— Ç'është kështu?

Njëri nga partizanët po këcente me një këmbë, pastaj u shtri në shpinë.

— U plagos! E sheh, aeroplani...eh faqezeztë...

Ato u afruan me një frymë. Në fytyrat e tyre dallohej dhimbja.

— Shoqe, — foli vajza partizane — aman, si t'ja bëjmë?..dhe tregoi të plagosurin.

Ja hoqën pantallonat. Kofsha e djathtë i qe shpuar tej matanë. Gjaku i shkonte çurkë tatë-pjetë gjurit. Por s'kish kohë për t'u menduar. Tarikua u sul me një frymë në shtëpi dhe u kthye menjëherë. Në dorë mbante një shishe me raki e fundin e përparses e kish mbledhur shuk; në të kishte duhan të grirë. Vuri buzën në gaz si për t'u dhënë zemër të tjerëve:

— Mos kini merak, do ta shërojmë ne. Nënat dhe motrat dinë të shërojnë plagë.

Ja fshiu gjakun me shami të qullur në raki rrushi, ja pllakosi plagën me duhan të grirë dhe ja lidhi me linjën e saj të bardhë. Partizanja i foli:

— Më të lumtë, o motër!

Tarikua u përkul mbi partizanin, i lëmoi flokët, që i kishin rënë mbi ballin e gjërë, pastaj i foli partizanes:

— Duhet lajmëruar në komandën e vendit, të vijë doktori a infermieri.

Dhe partizanja u nis.

«Djemtë luftojnë, por edhe vajzat si unë luftojnë maleve. Kaqe herë kam dëgjuar «Ajo çupa e Selimit barabar me një burrë lufton! Apo s'është edhe e pashme, me sy të rrëzon përdhe». «Vajza e Rushitit zuri të gjallë një gjerman». Po sikur të isha edhe unë partizane! Sa do çuditej babai kur të dëgjonte: «E bija e Ademit të merr gjak në vetull; shtëpi pushke ka qenë e tyrja dhe do të mbetet»

Tarikua bëhej lulekuqe tek mendonte ashtu, i vinte mirë dhe i dukej sikur fluturonte në ato përfytyrime të dashura. Nga e përpjeta mbi fshat erdhën gjer këtej ca zëra të shqetësuarra dhe pra-pë që andej u sulën nëpër hapësirë ca korba të zez, ndofta të trembur nga çapet e partizanëve. «E zeza unë, m'u dogjën bukët në furrë!». Ajo hoqi dorezën e furrës. Ju dogjën pak duart, por i duroi. Gimi arriti me një krahë dru në kurriz.

— Ama ç'm'i solle drutë shpejt ti, Gimi!

— U vonova se dy partizanë (njëra ishte cupë) kishin humbur rrugën e i nxora gjer këtu.

— T'u bëftë motra ty!

Djali ish afruar, dukej serioz dhe sikur donte të tregohej më i madh. Qëndroi me duar mbi shkopin e vet dhe pastaj u ngjiti përpjetë shkallëve duke vrapuar. E motra e ndoqi dhe e arriu mu te dera e dhomës, ku ishte shtrirë i plagosuri.

— Sht...

Ajo vuri dorën para gojës dhe e hoqi mënjane:

— Është i plagosur, njëri nga ata të dy që përcolle ti...

— Ashtu?

Sytë e djalit u zmadhuan dhe buzët iu terën.

— Ashtu, xhan i motrës.

— Rëndë është plagosur?

— Jo, jo, në këmbën e djathtë, por ti nisur tashti se ke lënë Dritën vetëm.

— Ika, ika, por do të vij shpejt.

Ajo e kuptoi se të vëllanë e digjte kureshtja për të parë partizanin, por e nisi. Pastaj përsëri hyri në odë. Aty ishte shtrirë në shpinë i plagosuri:

— Mos ki merak, — i dha zemër vajza, — doktori do të vijë shpejt.

— Jo, moj motër, s'e kam hallin aty, por më vjen keq. Si, xhanëm, të plagosesh kështu larg luftës? Hej qen gjerman, se ç'dreq marifetesh ka shpikur!..

Sytë e të dyve u takuan dhe menjëherë Tarikos iu kujtua i vëllai me atë shenjën e prerë në buzën e majtë. I dukej Tarikos se i vëllai, ai që ishte malit partizan, ishte më i miri, më i bukuri, më trimi ndër të gjithë shokët.

«E zeza unë, ç'mendoj kështu?» Përsëri pa sytë e partizanit dhe i buzëqeshi. Edhe ai vuri buzën në gaz, por Tarikua uli sytë dhe, duke ulur sytë, vështrimi iu ndal te këmbët e djalo-shit: «Si nuk e vura re që në krye këtë?»

Atje nën gjunjët, çorapet e partizanit ishin të grisura.

Ai e shihte dhe ajo turpërohej: «E zeza unë, ç'bëj kështu? Ai më shikon... po pse të mos më shohë? Le të më shohë...»

Dhe sytë i ndritnin, i shkëlqenin, i merrnin zjarr, dukej sikur ndizeshin shkëndija. Në oborr dëgjoi zhurmë. U sul tatëpjetë shkallëve. Mu në hyrje takoi ballë për ballë tre partizanë. Ishte edhe ajo vajza që kish shkuar për mjekun. Me duart në gjoks ajo u fliste:

— Ju lutem shumë, bëni të pamundurën ta shërojmë shpejt... .

Mjeku hapi çantën dhe mbi një pecetë të bardhë vendosi veglat e tij; pastaj u kërrus mbi të plagosurin dhe i hoqi linjën e bardhë nga kofsha. Djali, i shtrirë, kafshonte buzën e posht-

me. Mjeku u ngrit përsëri dhe vështroi anembanë:
— Plagë e thellë dhe e gjerë... po të mos
qe ndalur gjaku... Ju paska shkuar mirë ndër
mend... kush ja pllakosi me duhan?

Foli partizanja:

— Ja, kjo vajza e shtëpisë. Unë s'dija se
çfarë t'i bëja.

— Ashtu? — fytyra e mjekut qeshi.

— Ti, motër, ke meritën që e shpëtove këtë
trim. Por ti nuk e njuh këtë djalë. Ky një ditë
na ka shpëtuar jetën ne të gjithëve.

— Ashtu?

— Ky është një djalë hero!

Dhe Tarikua e re, ajo vajzë e thjeshtë ma-
lësore, pa e ditur kish kryer një heroizëm... ajo
i kish shpëtuar jetën një heroi.

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Duke kërkuar një emër	3
Emocion	10
Bardha	15
Atë e bijë u kuptuan	26
Ajo dhe të dy shokët	32
Një dhimbje pas vitesh	38
Duke kapërcyer lumin	47
E humba një shoqe	60
Vajzat që shëronin plagë	70